

1 E martë, 14 shtator 2021

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 14.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita dhe mirëserdhët të
7 gjithë brenda dhe jashtë sallës.

8 Zonja sekretare, ju lutem, paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
14 sekretare.

15 U lutem tani palëve dhe pjesëmarrësve të prezantojnë
16 veten duke filluar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

18 Në emër të Prokurorisë sot pas dreke ndodhet z. Alan
19 Tieger, prokuror i lartë; Ward Ferdinandusse, shef i hetimeve
20 në Prokurori; Marlene Yahya Haage, nëpunëse e nxjerrjes dhe
21 çështjeve juridike; dhe unë jam prokurore e lartë me emrin
22 Clare Lawson.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 U lutem ekipeve të Mbrojtjes të prezantohen, duke filluar
25 me z. Kehoe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

2 Më quajnë Federik Kehoe ndodhem këtu me z. Prosper,
3 personalisht dhe në distancë Luka Misetic dhe Dastid Pallaska
4 që janë të lidhur me videolink.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

7 Përshëndes të gjithë ata që janë në sallë dhe na ndjekin
8 nga larg. Më quajnë Ben Emmerson përfaqësoj z. Kadri Veseli së
9 bashku me bashkëavokatin Andrew Strong, i cili është i lidhur
10 nga larg me videolidhje me ne dhe bashkë me ne është Joanna
11 Frivet dhe Pascalon Langlais, menaxhere e çështjes që ndodhen
12 në sallë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

14 Z. Young.

15 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëdita, i
16 nderuar Gjykatës.

17 Unë paraqitem në emër të z. Rexhep Selimi së bashku me z.
18 Geoffery Roberts. Faleminderit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

20 Znj. Alagendra.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]
22 Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

23 Venkateswari Alagendra përfaqësoj Jakup Krasniqi,
24 paraqitem së bashku me z. Aidan Ellis, Mentor Beqiri dhe z.
25 Victor Baiesu.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

2 Alagenda.

3 Për hir të procesverbalit vë re se z. Thaçi, z. Veseli,
4 Z. Selimi dhe z. Krasniqi nuk ndodhen fizikisht të pranishëm
5 në sallë, por marrin pjesë në këtë seancë përmes videolidhjes.

6 I jap fjalën tani Mbrojtësit të Viktimave, z. Laws. Ju
7 lutem.

8 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëdita.

9 Më quajnë Laws, jam përfaqësuesi i viktimave.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 I jap fjalën Zyrës Administrative z. Roche fjala për ju.

12 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

13 Më quajnë Ralph Roche përfaqësoj Zyrën Administrative.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Për hir të procesverbalit unë jam Nicolas Guillou,

16 Gjykatësi i Procedurës Paraprake për këtë çështje.

17 Më datë 8 shtator 2021, kam caktuar datën e kësaj
18 konference të shtatë mbi ecurinë e çështjes.

19 U kam kërkuar palëve që të paraqesin parashtime me
20 shkrim po të dëshironin. Më datë 13 shtator, ZPS-ja dhe
21 Mbrojtja e z. Krasniqi kanë parashtuar pikëpamjet e tyre me
22 shkrim. I falënderoj palët për parashtimet me shkrim.

23 Qëllimi i seancës sot, si zakonisht, është që të
24 shqyrtojmë ecurinë e çështjes gjyqësore dhe të diskutojmë për
25 temat që kemi parashikuar në rendin e ditës që janë: nxjerrja

1 e materialeve, përkthimet, hetimet e ZPS-së, hetimet e ekipeve
2 të Mbrojtjes dhe paraburgimi. U lutem palëve që të paraqesin
3 pikëpamjet e tyre në mënyrë koncize për secilën pikë të rendit
4 të ditës. U lutem palëve që të na njoftojnë paraprakisht nëse
5 ndonjë parashtrim kërkon nxjerrjen e informacioneve
6 konfidenciale në mënyrë që të kalojmë në seancë private apo të
7 mbyllur.

8 Të fillojmë atëherë me temën e parë të rendit të ditës,
9 që ishte parashikuar në urdhrin e caktimit të datës, bëhet
10 fjalë për nxjerrjen e materialeve. U jap fjalën palëve për
11 nxjerrjen e materialit të çdo kategorie, pra, të materialeve
12 provuese më vete. Së pari, materialet e rregullit 102(1)(a),
13 që janë materialet provuese të dorëzuara së bashku me
14 Aktakuzën; pastaj materiali 102(1)(b), që është materiali
15 provues që ZPS-ja synon të përdorë në gjykim; pastaj është
16 materiali i rregullit 102(3) që është materiali me rëndësi për
17 çështjen gjyqësore, siç është përmendur nga ZPS-ja; pastaj
18 materiali i rregullit 103 që është materiali shfajësues; dhe
19 në fund, materiali i rregullit 107 që janë materialet e
20 mbrojtura për të cilat nevojitet dhënia e pëlqimit nga dhënësi
21 i informacionit.

22 Kalojmë tani me materialet e rregullës 102(1)(a) që janë
23 nxjerrë tashmë nga ZPS-ja.

24 Mbrojtja ka kërkuar një zgjerim të nënkategorizimit në
25 sistemin *Legal Workflow* për të përfshirë dhe materiale të

1 rregullit 102(1)(a) për të cilat është diskutuar në
2 konferencën e mëparshme mbi ecurinë e çështjes. Dua, edhe
3 njëherë, të dëgjoj mendimin e Mbrojtjes nëse ende mendojmë se
4 ky nënkategorizim është i nevojshëm për të përgatitur provat e
5 tyre.

6 Vërej se ekipi i Mbrojtjes së z. Krasniqi, ka bërë të
7 ditur në parashtrimet e veta se lista paraprake e dëshmitarëve
8 dhe paketat përkatëse të dokumenteve do të ishin me një
9 prioritet më të lartë për Mbrojtjen sesa kategorizimi i
10 materialit të rregullit 102(1)(a).

11 Në fund, do të doja që të dija nga ZPS-ja se ç'ndikim do
12 të kishte ky nënkategorizim, më saktë zgjerimi i këtij
13 nënkategorizimi, tek përmbushja e afateve nga ana e atyre
14 lidhur me nxjerrjen e materialeve.

15 Dua të filloj me Mbrojtjen, me z. Kehoe, fillimisht.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës.

17 Në emër të z. Thaçi, ne do ta nxisnim Gjykatën që të
18 jepte urdhër që materialet e rregullit 102(1)(a) që të na
19 jepeshin me nënkategorizim në sistemin *Legal Workflow*.

20 Sigurisht, ky informacion është nxjerrë në bazë të
21 rregullit 86(3)(b). Mirëpo, po të shohim dokumentet, në fakt,
22 aty ka shumë poshtëshënime në të gjitha dokumentet, nuk e di
23 nëse e kam gabim, po ka mbi 4000 shënime poshtë faqes. Dhe
24 këto poshtëshënime kanë rreshta me informacione për kushedi se
25 për çfarë.

1 Pra, ndodhemi përpara një potpurie informacionesh e cila
2 nuk është zbërthyer në paketat e nxjerrjes sipas nën rregullit
3 (b)(1). Pra, ajo që duam që të dimë është që të shikojmë se ku
4 do mbështeten me saktësi prokurorët në ç'informacione nga ato
5 që na kanë dhënë neve, që na e kanë dhënë sipas rregullit
6 102(1)(a). Në fakt, është thuar se e pamundur me mbi 4000
7 poshtëshënime dhe këto nuk janë thjeshtë poshtëshënime. Besoj
8 e keni vënë re dhe ju, janë shënime të cilat kanë
9 informacione, të dhëna nga dëshmitarët për dëshmitarët, është
10 thuar se e pamundur që të kategorizohet ky informacion në
11 kundërshtim informacioneve sipas rregullës 86.

12 Pra, për ta thjeshtuar punën, jo vetëm tani, por edhe për
13 Gjykatën në përgjithësi, do të ishte shumë e dobishme që
14 Gjykata t'i jepte urdhër Prokurorisë që këtë informacion ta
15 vendoste në kategorizim në mënyrë të njëjtë apo të ngjashme
16 siç kanë vepruar me materialin e paragrafit (1)(b) në mënyrë që
17 të përshpejtonte punën për të gjithë, jo vetëm për klientin
18 tim z. Thaçi. E mirëpres çdo pyetje, desha të jem konciz.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

20 Z. Emerson për këtë temë për rregullin 102(1)(a).

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në përgjithësi, siç jeni në
22 dijeni, i nderuar Gjykatës, Prokuroria është vonuar me paketat
23 dhe ka nxjerrë shumë paketa kohët e fundit, të cilat do t'u
24 përgjigjemi më pas. Por, do të donim përgjigje, pra, do donim
25 t'u jepnim përgjigje të hollësishme pyetjeve që ju keni bërë

1 po këtë do ta bëjmë drejt nga fundi i seancës.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Strong, për temën e
3 nënkategorizimit ç'keni për të thënë.

4 Z. STRONG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëdita.

5 Në përgjithësi, jemi dakord me parashtimet e bëra më
6 parë nga z. Kehoe. Shpresojmë që të mos jetë një propozim me
7 alternativa që ose të bëjmë këtë, pra, ose të bëjmë listën e
8 dëshmitarëve në kohë ose të merremi me nënkategorizimin.

9 Një prej përfitimeve të mëdha të nënkategorizimit për
10 kategoritë që janë përdorur për provat është se na jep mundësi
11 që të bëjmë kërkime në tërësinë e provave që na janë nxjerrë
12 nëse ka ndonjë gjë, ndonjë qoshe të mbetur të pakategorizuar
13 mund të mbetet i pazbuluar përmes një kërkimi, sipas
14 kategorizime apo nënkategorizime. Kjo është një gjë e cila
15 duhet zgjidhur. Unë këtu po i mbyll komentet e mia për këtë
16 çështje.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Strong.
18 z. Young, ju lutem.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

20 Në përgjithësi mbështesim parashtimet e z. Kehoe të bëra në
21 emër të z. Thaçi dhe parashtimet me shkrim që janë bërë në
22 emër të zotit Krasniqi në paragrafin pesë dhe gjashtë të
23 parashtimit të tyre. Do të ishte vërtet e dobishme që të
24 zgjerohej nënkategorizimi, sipas këtyre parashtimeve.

25 Sigurisht, është më e rëndësishme që Prokuroria t'i përmbushë

1 detyrimet që u kanë mbetur për nxjerrjen. Por zgjerimi i
2 nënkategorizimit do të ishte i dobishëm për menaxhimin e
3 çështjes nga ana jonë. Faleminderit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Young.

5 Znj. Alagendra, duke e ditur që ju jeni ajo që keni
6 dorëzuar kërkesën paraprake për këtë temë.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] A mund
8 t'i lutem z. Ellis që t'ju drejtohet për këtë?

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis, fjala për ju.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, është e
11 vërtetë. Jemi ne ata që e dorëzuan këtë kërkesë, ishim të
12 parët dhe i qëndrojmë këtij parashtimi, siç kemi bërë edhe në
13 konferencën e fundit për ecurinë e çështjes dhe mbështesim dhe
14 parashtimet e bëra gojarisht sot nga ekipet e tjera të
15 Mbrojtjes.

16 Argumenti është që edhe pse mbetet ende një tërësi
17 materialesh në *Legal Workflow* që nuk janë objekt i
18 kategorizimit, dobia e kategorizimit si një mjet për të
19 kërkuar bie. Të gjitha ekipet e Mbrojtjes, mbase edhe çdokush
20 tjetër, që do që të bëj kërkime duke përdorur funksionin e
21 kategorizimit mund ta bëj këtë.

22 Pra, ne parashtrojmë se mbetet me përfitim, sigurisht,
23 kërkon një farë kohe për të bërë nënkategorizimin po ne
24 parashtrojmë se, nëse bëhet kjo gjë tani, do t'i ndihmonte të
25 gjitha palët në të ardhmen.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

2 Ja jap fjalën ZPS-së. Znj. Prokurore, fjala është për ju.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

4 Për këtë temë, ne i kemi parashtruar më përpara arsyet pse ne
5 nuk mendojmë që nënkategorizimi është, pra, nënkategorizimi
6 si për materialin e rregullit 102(1)(a) është i justifikuar,
7 prandaj dhe nuk mendojmë se është një përdorim i mirë i
8 burimeve të kufizuara që kemi. Rëndësia e materialit të
9 rregullit 102(1)(a) trajtohet jo vetëm në përmbledhjen sipas
10 rregullit 86(3)(b), siç iu përmend nga Mbrojtja e z. Thaçi, po
11 materialet në fjalë kanë qenë në dispozicion të Mbrojtjes për
12 shqyrtim dhe analizim prej nëntë muajsh, afërsisht nëntë
13 muajsh tashmë.

14 Poshtëshënimet që janë përmendur nga Mbrojtja e z. Thaçi
15 nuk janë abstrakte. Ato, sigurisht, mbështesin pohime apo
16 deklarata të caktuara që bëhen në përmbledhjen për të dhënë më
17 shumë hollësi. Prandaj është relativisht e lehtë për të --
18 madje është shumë e lehtë do të thosha për të parë se cili
19 shënim poshtë faqes lidhet me cilin vend dhe me cilën pikë të
20 akuzës, prandaj dhe ne i qëndrojmë qëndrimit tonë.

21 Janë 1800 materiale të nxjerra sipas rregullës 102(1)(a)
22 dhe përvoja jonë deri tani ka treguar se nënkategorizimi, që
23 bëhet manualisht kërkon shumë burime dhe në momentin që
24 ndodhemi nuk është diçka e cila mund të bëhet pa i pakësuar më
25 tej burimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tjera për

1 këtë çështje që u përmendën.

2 U përmend faktikisht nga avokati i z. Veseli që është
3 vërtet një alternativë ose kjo ose ajo. Por duam të themi që,
4 është bërë e ditur si nga z. Krasniqi edhe nga Mbrojtja e z.
5 Krasniqi dhe ajo z. Selimi, që lista paraprake e dëshmitarëve
6 përbën një prioritet më të lartë dhe në fakt, kjo na ndihmon
7 edhe ne sepse ne jemi të qëndrimit se çfarëdo lloj hapash të
8 tjerë mund të ndërmarrim brenda asaj që na kërkohet nga kuadri
9 ligjor. Ne mund ta bëjmë këtë por duke parë sesa e dobishme
10 është për palët dhe nëse mund ta bëj në atë mënyrë që nuk na
11 cenon mundësinë për të përmbushur detyrimet tona në vijimësi.

12 Gjithashtu falënderojmë Mbrojtjen e Krasniqi që ka bërë
13 shkëmbim *inter partes*. Propozimet që ata kanë bërë kanë qenë
14 shumë të dobishme për ne. Ne me kënaqësi do t'i vijojmë këto
15 diskutime me ta dhe shpresojmë që do të arrijmë zgjidhje për
16 një sërë syresh. Parashtrimet e Mbrojtjes i kanë përmendur se
17 cilat janë këto probleme dhe që pritet që t'i raportohet
18 Gjykatës në konferencën e ardhshme mbi ecurinë e çështjes,
19 kështu që nëse do të pajtohemi do t'i japim përditësim të
20 mëtejshëm Gjykatës atëherë. Faleminderit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

22 Prokurore.

23 Z. Kehoe.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Shumë shkurt. Pra, në thelb ajo që
25 po thotë Prokuroria është se nuk duan që të bëjnë

1 nënkategorizimin se është i vështirë ose se u kërkon shumë
2 kohë. Po të jetë i vështirë dhe u kërkon kohë Prokurorisë për
3 ne atëherë është e pamundur fare. Ka një larmi informacionesh
4 besoj, i nderuar Gjykatës, është në dijeni të dokumentit dhe
5 sasisë së informacioneve që ndodhen në ato poshtëshënime të
6 cilat ne duhet t'i shoshitim e për të kuptuar se çfarë do të
7 bëjë Prokuroria me të gjitha këto informacione që kanë
8 përfshirë aty dhe ku lidhen, me çfarë lidhen dhe ato thonë se
9 nuk duan ta bëjnë se është e vështirë?

10 E atëherë unë ju parashtroj se kjo nuk është në përputhje
11 me parimin e barazisë midis palëve duke qenë se ato bëjnë
12 nxjerrjen e materialit në bazë të rregullit 102(1)(a) dhe nëse
13 kanë ndërmend që ta përdorin këtë informacion dhe janë gjithë
14 këto shënime poshtë faqes dhe ato mund të thonë "ua kemi
15 nxjerrë është këtu", po nuk na thonë se në ç'kategori bëjnë
16 pjesë. Unë e kuptoj që është e vështirë. E kuptoj vështirësinë
17 sepse jemi përpjekur që ta bëjmë vetë dhe kemi arritur në këtë
18 konkluzion, ama është informacioni i Prokurorisë, prandaj
19 Gjykatës ne ju lutemi që i takon Prokurorisë që ta zbërthejë
20 këtë me një nënkategorizim për të krijuar një ide se çfarë
21 provash do të propozojnë mbi çfarë çështjes, mbi çfarë
22 aspektesh dhe kjo përputhet me parimin e barazisë midis
23 palëve. Prandaj, unë i lutem Gjykatës, që të ndiqet kjo
24 procedurë njësoj si me materialet e rregullit 101 --
25 102(1)(b), më falni.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit z. Kehoe.

2 Ndonjë ekip tjetër i Mbrojtjes ka dëshirë të marrë
3 fjalën? Nuk shoh asnjë kërkesë.

4 Po znj. Prokurore, shkurt, ju lutem.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shumë shkurt, i nderuar Gjykatës.
6 Dëshiroj që të nënvijëzoj se ka pasur një keqparaqitje të
7 parashtimeve tona. Jo se ne nuk duam ta bëjmë, në fakt, ne e
8 kemi bërë në përmbledhjen e hollësishme ku e kemi zbërthyer me
9 hollësi me më shumë kategorizim sesa do të ndodhte me
10 nënkategorizimin që do të bëhej në *Legal Workflow*. Parashtimi
11 që unë bëra është se në këtë moment në të cilin ndodhemi nuk i
12 kemi burimet, do të na duhet t'i heqim nga një detyrim tjetër
13 që mund të ishte me një prioritet më të lartë, siç e kanë
14 thënë dhe ekipet e Mbrojtjes, për të kaluar këtë burim tek
15 materialet e *Legal Workflow*.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit znj.
17 Prokurore.

18 Kalojmë tani tek materialet e rregullit 102(1)(b).

19 Do të doja që të dija se çfarë progresi është arritur sa
20 i takon nxjerrjes së materialit të rregullit 102(1)(b). Vërej
21 se ZPS-ja ka nxjerrë 24 paketa me material të rregullit
22 102(1)(b,) por ka ende materiale të tjera që ende nuk janë
23 nxjerrë.

24 Duke pasur parasysh që po afrohemi edhe afati i datës 27
25 shtator 2021; dua që ZPS-ja të na bëjë të ditur edhe sa

1 material i tillë mbetet për tu nxjerrë; edhe sa prej këtij
2 materiali do të mbetet pa nxjerrë pas afatit të datë 27
3 shtator 2021, nëse do të mbetet; nëse lista e materialit të
4 paragrafit 3 të parashtimeve me shkrim që ka paraqitur është
5 ezauruese apo jo; dhe unë këtu ju kujtoj të gjitha palët që
6 kjo listë përmban, së pari, deklaratat e tre dëshmitarëve
7 ndërkombëtarë për të cilët ende nuk është marrë miratimi sipas
8 rregullit 107; së dyti, janë raporte nga tre dëshmitarë
9 ekspertë në lidhje me çështjet kriminalistike; dhe, së treti,
10 materiale të caktuar që janë objekt i kërkesave për ndryshim
11 të masave mbrojtëse; dhe nëse kjo listë nuk është ezauruese,
12 do t'ju lutesha ZPS-së, të na thotë se cilat janë materialet
13 të cilat ende nuk janë nxjerrë sipas rregullit 102(1)(b).

14 I lutem ZPS-së, gjithashtu, të na bëjë të ditur nëse
15 kërkon një shtyrje tjetër të afatit të datë 27 shtator dhe
16 nëse po, për të cilat materiale të rregullit 102(1)(b).

17 Gjithashtu, e kuptoj nga parashtimet e ZPS-së që
18 përkthimi i materialit të rregullit 102(1)(b) nuk do të jetë
19 përfunduar plotësisht brenda afatit të tanishëm 27 shtator dhe
20 për pasojë, ZPS-ja kërkon një shtyrje të afatit për nxjerrjen
21 e përkthimeve që kanë mbetur pa u nxjerrë. I lutem ZPS-së që
22 të na japë hollësi mbi afatet e pritura se kur mund të
23 finalizohen këto përkthime.

24 Së fundi, vërej se në parashtimet e veta me shkrim ZPS-
25 ja ka bërë të ditur se nuk do të jenë të nevojshme kërkesa të

1 mëtejshme për masa mbrojtëse për materialin e rregullit
2 102(1) (b) në funksion të nxjerrjes së këtij materiali. I lutem
3 ZPS-së që t'i konfirmojë parashtrimet e veta me shkrim për
4 këtë pikë.

5 Znj. Prokurore, keni fjalën.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Siç vutë në dukje që nga
7 konferenca e fundit janë nxjerrë 24 paketa të rregullit
8 102(1) (b) dhe disa të tjera janë duke u bërë gati deri për 27
9 shtator.

10 Lidhur me çështjet konkrete të përcaktuar në konferencën
11 e fundit është bërë përparim i dukshëm. Dy nga dëshmitarët
12 ndërkombëtarë janë miratuar dhe janë bërë të njohur dëshmitë e
13 rregullit 107 gjithashtu janë miratuar dhe nxjerrë. Kërkesat
14 për masa mbrojtëse janë bërë dhe materiali në fjalë është
15 nxjerrë apo do të nxirret në afatin e duhur. Dhe së fundi,
16 ndryshime në masat mbrojtëse janë miratuar lidhur me materiale
17 që kanë të bëjnë me pesë dëshmitarë. Dhe këto materiale janë
18 nxjerrë apo do të nxirren në afatin e kërkuar.

19 Gjithashtu presim që raportet nga tre ekspertë do merren
20 brenda datës 27 shtator që është afati. Siç vë dukje në
21 parashtrim, mund të jetë e nevojshme të bëhen disa redakte
22 lidhur me emrat e dëshmitarëve dhe të ekspertëve. Nuk i kemi
23 parë ende raportet dhe nuk e konfirmojmë dot nëse do të ndodhë
24 kështu apo të bëjmë ndonjë kërkesë përkatëse por, nëse do të
25 lind nevoja, do ta bëjmë në rastin më të hershëm, posa që t'i

1 kemi marrë raportet.

2 Kjo është çështja e vetme e mbetur lidhur me masat
3 mbrojtëse që lidhet me mundësinë që kemi për të nxjerrë
4 materialet e tjera të rregullit 102(1)(b).

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më falni, që ju ndërpres.
6 Për këtë çështje do të bëni një kërkesë për masa mbrojtëse apo
7 do t'ju duhet të bëni disa kërkesa në varësi të raporteve. A
8 mund të bëni vetëm një parashtrim të konsoliduar për të gjitha
9 këto?

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shpresojmë që të mund të bëjmë
11 një parashtrim të vetëm të konsoliduar në varësi të datës se
12 kur do t'i marrim raportet. Pra, do ta vonojmë kërkesën nëse
13 ndonjë raport vjen më vonë sesa e presim. Kështu që shpresojmë
14 që të bëjmë një kërkesë të konsoliduar për të gjitha.

15 Siç vutë në dukje, i nderuar Gjykatës, ka disa pika të
16 cilat i kemi identifikuar në parashtrimin tonë ku nuk jemi
17 ende në gjendje të konfirmojmë se do të përfundojnë miratimet
18 apo ndryshimet e nevojshme. Janë tre, bëhet fjalë për tre
19 dëshmitarë ndërkombëtarë që për të cilët vazhdon procesi i
20 miratimit, për fat të keq, në këtë moment nuk e konfirmojmë
21 dot nëse miratimi do të bëhet deri në 27 shtator; një nga
22 dëshmitarët p.sh., është duke udhëtuar në një vend të largët
23 dhe ka pak qasje në material, gjë që mund të prekë mundësinë e
24 tij për të ndërvepruar me organizimin dhe me përpjekjet për të
25 miratuar materialet.

1 Përveç tre dëshmitarëve ndërkombëtarë, është dhe një
2 dëshmitar lidhur me të cilin vazhdojnë diskutimet për masat
3 mbrojtëse, për ndryshimin e masave mbrojtëse. Shpresojmë që të
4 mund t'i nxjerrim në afatin e duhur intervistat e tyre. Por
5 nuk është e sigurtë nëse intervista e parë do të jetë e
6 disponueshme në atë ditë, është një çështje që pret vendime
7 gjyqësore të institucioneve të ndryshme.

8 Dhe së fundi, ka gjashtë persona për të cilët i kemi
9 nxjerrë transkriptet e para dhe kemi kërkuar ndryshimin e
10 masave mbrojtëse për të mundur të nxjerrim versione më pak të
11 redaktuara. Kërkesa është miratuar, por po presim marrjen e
12 materialeve. E kuptojmë që përgatitja e tyre është një çështje
13 që kërkon shumë punë, kështu që, s'kemi konfirmim ende nga
14 palët e treta nëse do t'i përgatisin dhe do të na i japin në
15 kohën përkatëse.

16 Këto janë çështjet ku kemi një farë pasigurie nëse do të
17 jemi apo jo në gjendje të realizojmë afatin e 27 shtatorit.

18 Sikundër e vutë ju në dukje, i nderuar Gjykatës, në
19 parashtrimin tonë kemi kërkuar zgjatjen e afatit lidhur me
20 përkthimet. Dhe përkthimet e materialit të rregullit 102 janë
21 duke u bërë. Është trajtuar si përparësi për ekipin e
22 përkthyesve dhe ka qenë e tillë për shumë muaj. Të gjitha
23 përkthimet e disponueshme, po gjithë burimet po merren me këtë
24 punë.

25 Nuk mund t'ju jap në këtë moment një vlerësim të saktë, i

1 nderuar Gjykatës, po pritet që puna të vazhdojë për një numër
2 muajsh me këto materiale. Ne do të vazhdojmë të nxjerrim
3 përkthimet në mënyrë të vazhdueshme posa që t'i marrim dhe
4 posa që të kemi bërë redaktimet e nevojshme.

5 Jam këtu për pyetje të tjera që mund të keni, i nderuar
6 Gjykatës.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A mund të konfirmoni, znj.
8 Prokurore, që lista e materialeve të rregullit 102(1)(b) është
9 shteruese dhe ato nuk do t'i bënit deri në 27 shtator janë nuk
10 janë materiale që s'i keni përmendur sot?

11 E them këtë sepse në parashtrimin tuaj me shkrim thuhet
12 përfshin dhe fjala "përfshin" është ndonjëherë jo shumë e
13 saktë mund të të ngatërrojë.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Keni të drejtë. "Përfshirë" është
15 thënë qëllimisht sepse ka një numër materialesh të tjera që
16 lidhen me ndryshimin e masave mbrojtëse të cilët nuk i kam
17 përmendur sot këtu por nuk e kam bërë këtë sepse besojmë që do
18 t'i kemi dhe do t'i nxjerrim në afatin e duhur.

19 Pra, materialet që përmenda janë shterues lidhur me atë
20 që presim.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

22 Në lidhje me përkthimet përmendët disa muaj. Doni të
23 thoni se kjo do të tejkalojë fundin e këtij viti apo këtë e
24 shihni si një çështje që ka të bëjë me dy-tre muaj? Me qëllim
25 që Mbrojtja të ketë një ide se çfarë të presë.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Vlerësimi aktual që kemi synon që
2 përkthimet të mbarojnë brenda këtij viti. Nuk mund ta them me
3 siguri për shkak të natyrës së punës dhe disa dokumente
4 kërkojnë më shumë kohë për t'u përkthyer se të tjerat.
5 Sigurisht, qëllimi, synimi ynë dhe plani është që të
6 përfundojnë në dhjetor por, siç thashë, nuk jam në gjendje t'u
7 jap një përgjigje përfundimtare sot.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 I kthehem Mbrojtjes.

10 Z. Kehoe, lidhur me materialet e rregullit 102(1)(b).

11 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në emër të z.
12 Thaçi. Mund të them se nuk jam ende i qartë lidhur me vëllimin
13 e materialeve që duhet të marrim deri në 27 shtator.

14 Dua të tërheq vëmendjen tuaj dhe më falni, në qoftë se
15 nuk them atë që duhet, por dua që të vazhdoj nga ato që thatë
16 në konferencën e fundit për status kur Prokuroria thanë që
17 janë në rrugën e duhur lidhur me materialet e rregullit, të
18 nxjerrjes së materialeve, të rregullit 102(1)(b).

19 Dhe si rrjedhojë, që nga ajo kohë, që nga ajo seancë apo
20 pak mbas saj kemi marrë mbi 11 000 dokumente, 10 000 mijë prej
21 të cilave ishin të rregullit 102(a) dhe (b). Në lidhje me
22 rregullin 102(1)(b) ishin, pra, 11 000 dokumente, 8542 prej
23 tyre ishin të rregullit 102(b), pra, 75 për qind e dokumenteve
24 që kemi marrë që lidhen me rregullin 102(1)(b) i kemi marrë
25 mbas seancës së fundit, që ishte në fakt, afati fillestar që

1 vendosët.

2 E kuptoj që ju e vutë afatin në 27. Po të marrësh 75 për
3 qind të dokumenteve të rregullës 102(1)(b) gjatë kësaj
4 periudhe, më bën që të mendoj. Dhe lidhet me kërkesën tuaj për
5 njoftim sipas rregullit 102(3) sepse s'kemi fare kohë për t'i
6 përtypur të gjitha këto.

7 Pra, ndërsa nuk janë 8542 faqe janë 8542 dokumente. Dhe
8 përbëjnë shumë faqe. Kështu që, siç thashë, morëm vetëm 75 për
9 qind të të gjithë dokumenteve mbas seancës së fundit. Duke e
10 pasur parasysh afatin 27 shtator nuk është e qartë se çfarë do
11 të marrim, sesi lidhet kjo me kërkesën tuaj për njoftim të
12 rregullit 102(1)(b) dhe kur do t'i marrim me vonesë. Në qoftë
13 se vonesa përfshin një kohë të gjatë, imagjinoni se për çfarë
14 vëllimi dokumentesh bëhet fjalë? Bëhet fjalë mijëra. As ne nuk
15 e dimë me saktësi bëhen për disa apo mijëra dokumente.

16 E hedh në tryezë për diskutim sepse është një proces i
17 vazhdueshëm. Po do të ketë nxjerrje materiale në një pikë
18 kohe, po ne duam të kemi kohën e duhur, sepse papritur na
19 jepen shumë dokumente që është e pamundur t'i studiosh, t'i
20 lexosh për të parë se çka në të. Dhe sa të tilla do të
21 ndodhin, sa të tilla do të marrim.

22 Po flas në emër të z. Thaçi sigurisht, po dhe kolegët
23 janë të shqetësuar për të njëjtën gjë. Kemi diskutuar për
24 nxjerrjen e dokumenteve që vazhdon për një periudhë kaq të
25 gjatë kohe? Dhe kur do të mbaroj? Që ne të ulemi me klientët

1 të cilët duhet të dinë se cilat do të jenë provat përkundrejt
2 diçkaje që vazhdon pafundësisht.

3 Ky është në fakt shqetësimi më i madh që kemi. Pra, për
4 çfarë bëhet fjalë? Çfarë do të marrim? Dhe jua lë fjalën dhe
5 kolegëve, ua jap ju fjalën nëse keni pyetje tjera për kolegët.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

7 Ju vutë në dukje një pikë të rëndësishme prandaj edhe e
8 pyeta ZPS-në sesa dokumente ka mbetur? Dhe pyeta nëse lista
9 është shteruese, se dhe unë jam i shqetësuar për atë që
10 mbeten. Ça janë 25 për qind, 75 për qind?

11 Z. Emmerson apo z. Strong.

12 Z. Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Disa fjalë në fillim për të
14 vazhduar me shkëmbimet që patët me z. Kehoe, ne të gjithë
15 dëgjojmë me vëmendje ato që tha Prokuroria lidhur me
16 paragrafin 3 të parashtrimit të vetë si shterues. Sigurisht,
17 kjo lidhet e materiale që ata parashikojnë të kërkojnë një
18 zgjatje tjetër të afatit përtej datës 27.

19 Shqetësimi ynë, për të cilin s'kemi marrë përgjigje nga
20 Prokuroria, është sa akoma dokumente të tjera do të nxirren që
21 tani deri në afatin 27 shtator. Nuk dua të them që unë ju
22 thashë por ju do ta kujtoni, i nderuar Gjykatës, fazat e para
23 të seancave të procedurave të kësaj çështje, ku Prokuroria
24 pretendonte me forcë se do të ishin gati për gjykim, për gjyq
25 tani dhe unë thashë, se përvoja tregon dhe ju kemi dhënë

1 statistika nga tribunale të ndryshme se afati kohor që
2 kërkojnë këto gjëra zgjaten, Prokuroria vazhdimisht, vetë z.
3 Black u ngrit, z. Smith, gjithmonë e gaboj e them z. Black.
4 Vetë z. Smith si dhe kolegja e nderuar sot e Prokurorisë u
5 ngritën dhe thanë përpara jush se i gjithë qëllimi ishte të
6 sigurohej që të mos ndodhnin vonesa të tilla dhe se ata ishin
7 gati për gjyq që në atë kohë.

8 Por ne ndërkohë kemi dëgjuar se në minutën e fundit, që
9 është muaji i fundit, 75 për qind e materialeve të Prokurorisë
10 janë nxjerrë. Të akuzuarit kanë qenë -- janë mbajtur në
11 paraburgim me shpresën që Prokuroria do të ishte e gatshme dhe
12 ne duhet të kemi parasysh sesa do të zgjati paraprocesi
13 gjyqësor. Prokuroria u përgjigj se ne po e sajojmë si të
14 thuash këto gjëra për të siguruar lirimin provizor.

15 Dua të dëgjoj, e kam bërë pyetjen dhe më përpara dhe
16 kolegja ishte ajo që e bëri këtë vlerësim. Dhe dua të dëgjoj
17 atë të kërkoj falje për këtë që të akuzuarit vazhdojnë që të
18 mbeten në paraburgim.

19 Prokuroria e ka ditur gjatë gjithë këtyre seancave se 75
20 për qind e materialeve nuk ishte bërë e njohur. Ato e kanë
21 ditur. Ato e dinë se çfarë kanë dhe çfarë thonë. Dhe ju
22 keqdrejtuan, duhet ta thonë hapur. Të gjithëve na gënjyen si
23 të thuash. Nuk kam parë njeri të sillet kjo të ishte diçka
24 normale. Nuk është normale. Është vërtetë jo normale,
25 anormale, që një prokuror i përgjegjshëm të sillet në këtë

1 mënyrë. Më vjen keqe po kështu është. Dhe nuk shoh asnjë
2 shenjë nga ana e tyre që të ndihen keq apo ta pranojnë apo të
3 shqetësohen për mungesën e profesionalizmit të tyre si
4 prokurorë.

5 Është minimumi që mund të thuhet. Diçka duhet bërë, jo
6 për mua, të gjithë e dinë që unë ankohem që në fillim mbase.
7 Por meqë jemi këtu përpara minutës së fundit që ju e zgjatët,
8 pra afatit, ku kemi marrë 75 për qind të materialeve dhe në
9 rastin e klientit tim prova të drejtpërdrejta të lidhura me
10 akuzat ndaj tij të cilat nuk na janë bërë të njohura për të
11 gjithë këto muaj që zotërinjtë kanë ndenjur në paraburgim.
12 Diçka duhet të thuhet me qëllim që të ruhet kredibiliteti i
13 këtij Tribunali, sepse njerëzit në gjithë botën po e ndjekin,
14 po e shikojnë sesi sillet ky Tribunal.

15 Në qoftë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake rri aty dhe
16 e shikon Prokurorinë të sillet kështu dhe të mos thotë asgjë,
17 vetëm t'i thotë dhe sa kohë ju duhet për ta zgjatur, ne të
18 gjithë jemi në situatë dhe ju e dini tani. Ne kishim të
19 drejtë, nuk mund të filloj gjyqi përpara verës që vitit që
20 shkoi vitit të ardhshëm, sepse vetëm tani Prokuroria po i
21 nxjerr materialet.

22 Nuk po sugjeroj që e keni fajin ju, është faji i
23 Prokurorisë sigurisht. Por a është ekziston përgjegjësia si
24 Tribunal, që e vlerësoj si një Gjykatë Kombëtare dhe jo
25 Ndërkombëtare dhe kjo do të marri rëndësinë e vet në kohën e

1 duhur që shikohet, vëzhgohet nga komuniteti ndërkombëtar dhe
2 ka shqetësime shumë reale për integritetin dhe po e përdor
3 qartë fjalën integritet, integritetin e Prokurorisë.

4 Ç'është kjo Prokurori që ju tregon, ju thotë në korrik se
5 është në rregull është në kohën e duhur dhe i mban zotërinjtë
6 në paraburgim dhe pastaj nxjerr vetëm 75 për qind të
7 materialeve pas kësaj.

8 Është çështje parimi, kjo që po them, përse na thonë se
9 do të kalojnë shumë muaj përpara se Prokuroria të mund të
10 nxjerrë materialet e përkthyer të rregullës 102(1)(b)? Është
11 e çuditshme sepse, siç e kuptoj unë, materialet e 101(b)
12 Prokuroria në këtë rast do të ketë vendosur nëse do t'i
13 përdorë apo jo këto materiale në gjyq. Ndryshe nuk do të ishin
14 materiale të rregullit 102(1)(b). Si mund ta kenë bërë këtë pa
15 përkthim? Apo ju japin një vlerësim të ndershëm z. Gjykatës?

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

17 Tani ja jap fjalën z. Young.

18 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do flas shumë
19 shkurt, se pajtohem me atë që thanë kolegët. Ne ndajmë
20 shqetësimin e shprehur nga z. Kehoe dhe Emmerson. Dhe ju bëtë
21 të njëjtën pyetje. Ka shqetësime të jashtëzakonshme, jo vetëm
22 për vëllimin e materialeve po [dhe] për përmbajtjen e tyre, e
23 cila nuk na është bërë e njohur si do të ndikojë në atë që
24 duhet përkthyer në shqip apo në anglisht lidhur me dokumente
25 që kanë përparësi.

1 Nga konferenca e fundit, ju kujtohet se unë e ngrita
2 çështjen e kapacitetit të Tribunalit për të përkthyer në
3 gjuhën e të akuzuarve që është esenciale, thelbësore pra për
4 Gjykatën. E paralajmërova këtë Gjykatë, e këshillova se mund
5 të ketë nevojë për burime të tjera për të përkthyer.
6 Kapaciteti i Gjykatës për të përkthyer materiale prioritare
7 nuk është ai që duhet ose nuk punon si duhet. Dhe këtu kemi
8 një numër shumë të madh materialesh të pa përkthyer, përpara
9 se Prokuroria të na japi emrat e dëshmitarëve, provat që ata
10 do të përdorin në Gjykatë lidhur me prova të ndryshme. Pra,
11 kur thashë herën e fundit se është një problem i madh, nuk e
12 kam mbivlerësuar, por është vërtetë një shqetësim që duhet ta
13 merrni parasysh në qoftë se këta zotërinj vazhdojnë të mbahen
14 të paraburgosur.

15 Pra, në një kohë që ka një mungesë njohurie për çështjen
16 që kanë, nuk e njohin çështjen e ngritur kundër tyre duhet ta
17 dinë. Pra, minimumi që duhet të bëjë Gjykata për të zbutur
18 dëmin është që t'iu bëjë të njohur këtyre njerëzve kushtet.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis, ju lutem.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe ne ndajmë
21 shqetësimin e ekipeve të tjera dhe i bashkëngjitemi mendimit
22 të tyre. Sidomos në lidhje me çështjen e përkthimit të
23 materialeve 102(1)(b) në anglisht që është gjuha e punës e
24 këtyre procedurave.

25 Ky proces nuk mund të quhet i përfunduar derisa

1 përkthimet t'i jepen Mbrojtjes. Sigurisht kjo na kufizon
2 mundësinë për të punuar me dokumentet, për t'i shikuar për t'i
3 analizuar ato që na jepen. Në qoftë se dokumentet nuk na vihen
4 në dispozicion në gjuhën e punës së Gjykatës të procedurave
5 dhe të dëgjojmë që duhen akoma dhe disa muaj përpara sesa
6 përkthimet të përfundojnë duhet të jetë vërtetë diçka shumë
7 shqetësuese.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

9 Tani t'i jap fjalën Prokurorisë. Znj. Prokurore a mund
10 t'i përgjigjeni konkretisht pyetjeve të z. Emmerson lidhur me
11 materialet e rregullit 102(b) që do të nxirren përpara 27
12 shtatorit që është afati, sepse ju e thatë se çfarë nuk do të
13 nxirret lidhur me sasinë që ishte shqetësimi që e ndanë gjithë
14 ekipi i Mbrojtjes. Çfarë pritet të dalë në javët e tjera
15 përpara afatit dhe pastaj do t'ua jap fjalën të gjithë
16 avokatëve të Mbrojtjes.

17 Znj. prokurore keni fjalën.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë do të filloj nga ajo pyetje.

19 Nuk kam shifrën e saktë në lidhje me numrin e dokumenteve
20 por nuk është një numër i madh. Po flasim për materiale që ne
21 presim t'i marrim. Unë nga kërkesat për ndryshimin e masave,
22 pra, nuk bëhet fjalë për materiale të mbetura apo që duhet të
23 përpunohen dhe të përgatiten për nxjerrje. Për t'ju dhënë një
24 numër të përafërt, sa u përpoqa të nxjerr një numër të
25 përafërt, besoj që bëhet fjalë për deklarata të mëparshëm apo

1 dëshmi të mëparshme në lidhje me 15, afërsisht 15 dëshmitarë
2 dhe këto kanë qenë objekt i masave për ndryshimin e -- i
3 kërkesave për ndryshimin e masave dhe presim që t'i dorëzojmë
4 brenda afatit paraprak. Pra, shkurt nuk bëhet fjalë për një
5 material voluminoz.

6 Në lidhje me pikat e tjera që u ngritën.

7 Nxjerrja e materialeve 102(1)(b) është bërë në vazhdimësi,
8 sikurse u shpjegua në konferencën e fundit për gjendjen,
9 kishte shumë faktorë që ndikoi në kohën e nxjerrjes së atyre
10 materialeve. Në bazë të kërkesës për nënkategorizim u desh që
11 disa materiale që tashmë ishin nxjerrë të kontrollohen edhe
12 njëherë. E dyta, duhet të caktohet përparësia e materialeve që
13 lidhen me dëshmitarët për të cilat duhen masa, duke marrë
14 parasysh natyrën e atyre materialeve duhet të bëhet eshë
15 kërkesat përkatëse tek Gjykatësi.

16 Është një proces që kërkon një rishikim të gjerë. Pjesa
17 më e madhe e stafit punojnë nga distanca për shkak të
18 kufizimeve në lidhje me Covid-in dhe nuk kanë qasje në
19 database qendrore të provave dhe e gjithë kjo kërkon kohë.

20 Disa nga ekipet e Mbrojtjes ngritën çështjen e nxjerrjes
21 nën këtë kontekst. Kuadri ligjor mundëson mekanizmin për
22 rishikimin e rregullit të mbajtjes në paraburgim dhe kjo bëhet
23 rregullisht. Në këtë moment dhe në bazë të rishikimit të
24 fundit të mbajtjes në paraburgim është konstatuar se rrethanat
25 që justifikojnë mbajtjen në paraburgim vazhdojnë të ekzistojnë

1 dhe dihet që të pandehurit kanë të drejtën e apelit të
2 vendimeve të gjykatës në lidhje me paraburgimin.

3 ZPS-ja nuk ka mashtruar askënd për sa i përket afateve
4 kohore. Afatet kohore janë të parapara në kuadrin ligjor të
5 ZPS-së.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Kehoe, shkurtimisht dhe në lidhje me materialin
8 102(1)(b).

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë pyeta dhe këtë pyetje bëri dhe
10 kolegu im në lidhje me materialet 102(1)(b). Për çfarë
11 materiali bëhet fjalë? Prokuroria tha 15 dëshmitarë. Pyetja që
12 kemi ne si Mbrojtje, në rregull është për numrin e
13 dëshmitarëve por provat që lidhen në mbështetjen e dëshmive të
14 atyre dëshmitarët për çfarë volumi materialesh bëhet fjalë?

15 Me fjalë të tjera, çfarë duhet të presim nga këto
16 materiale? Sa materiale, për sa materiale bëhet fjalë?

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, përpara se
18 t'ju jap fjalën do t'i jap një herë mundësinë prokurores që
19 t'i përgjigjet z. Kehoe. A mund të na jepni një shifër të
20 përafërt znj. prokurore?

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për fat të keq nuk mund të jem më
22 e saktë se ajo që isha sepse nuk kemi marrë materialet për të
23 cilat kemi kërkuar ndryshimin e masave. Mirëpo nuk e dimë
24 sasinë e materialeve që do e shoqërojnë atë kërkesë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson urdhëroni.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ky është edhe një shembull tjetër
2 i mënyrës sesi sillet Prokuroria. Unë kërkoja, të më kërkojnë
3 falje, për mënyrën sesi e kanë keqreprezentuar çështjen e tyre
4 dhe këtë nuk e mora.

5 Por ta lëmë këtë anash, të gjithë në këtë sallë dhe ata
6 që na shohin. Nuk ka asgjë konstante lidhur me punën e
7 Prokurorisë. Sikur të kish qenë ashtu do të ishim të gatshëm
8 për gjykim. Ne po na thuhet tani se kemi edhe materiale të
9 cilat nuk i kemi, nuk ua dimë sasinë e saktë që duhet të
10 nxirren dhe ata tashmë e dinë se nuk janë në gjendje ta
11 nxjerrin këtë material brenda afateve të duhura.

12 Dhe unë këtë e kam të vështirë ta kuptoj, si mundet një
13 material kaq voluminoz që duhet ende të përkthehet në anglisht
14 dhe Prokuroria nuk flet shqip dhe ka vendosur që këtë material
15 ta përdorë në gjykim.

16 Ka teknika të ndryshme që ka përdorur kjo Prokurori e
17 pandershme që t'ju mashtrojnë lidhur me atë se kur është e
18 gatshme të fillojë gjykimin. Por ky nivel i
19 mosprofesionalizimit...

20 Ju lutem uluni se ende nuk e keni radhën për të fol!

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mos ju drejtoni ashtu
22 prokurores sepse nuk është e udhës të veproni kështu.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] E shoh që po përpiqet të më
24 ndërpresë. Në goftë se nuk është fjala për faljen që e pyeta,
25 atëherë nuk ka nevojë që të më drejtohet. Mua po mi ndërpret

1 fjalët Prokuroria.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vazhdoni z. Emmerson, ju
3 lutem.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po kemi të bëjmë me një Prokurori
5 që nuk ka kredibilitet në aspektin e parashikimeve për
6 zhvillimin e gjyqimit. Kemi ne një shprehje në anglisht për
7 avokatët që përdorin fjalë për të mashtruar dhe kjo është
8 shumë e dukshme nga ajo që tha prokuroria, thuhet se nuk kanë
9 ide se për çfarë volumi materialesh bëhet fjalë dhe që duhet
10 të dorëzohet. Dhe nuk e dimë aspak në këtë moment se kur mund
11 të fillojë gjykimi dhe kur çështja do të jetë e gatshme për
12 gjykim.

13 Do të flas pak më vonë për hetimet e Mbrojtjes, por
14 momentalisht jemi në një situatë kur po ballafaqohemi me një
15 sjellje joprofesionale të Prokurorisë dhe diçka duhet të
16 bëhet, masat duhet të merren që kësaj t'i jepet fund.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.
18 Znj. prokurore a doni të përgjigjeni tani?

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju faleminderit. Unë desha të
20 them vetëm që parashtrimet duhet të bëhen në mënyrë të
21 civilizuar në sallë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, znj.
23 Prokurore dhe i lus të gjithë të pranishmit në këtë sallë që
24 mos sillen në mënyrë agresive ndaj njeri-tjetrit.

25 Tani kërkoj nga z. Young, në qoftë se ka parashtrime të

1 na i bëjë të ditura.

2 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, nuk kemi
3 gjë për të ngritur.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Znj. Alagendra ose z. Ellis.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Me lejen
7 tuaj, e kam të qartë që Prokuroria nuk është në gjendje të na
8 thotë në këtë moment se për çfarë vëllimi materialesh bëhet
9 fjalë.

10 A mund ta pyesim Prokurorinë që të na qartësojë në qoftë
11 se ajo që kemi marrë deri tani është 75 për qind e materialit
12 102(1)(b)? Atëherë a është kjo e saktë ose jo?

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit znj.
14 Alagendra.

15 Znj. prokurore, a jeni në gjendje t'i përgjigjeni kësaj
16 pyetje?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pyetja ishte në qoftë se ajo,
18 Mbrojtja ka marrë deri tani është 75 për qind i materialeve
19 102(1)(b)? Për mendimin tim bëhet fjalë për një përqindje më
20 të madhe se 75 të materialeve të rregullit 102(1)(b). Unë
21 mendoj se nuk ka mbetur 25 për qind për t'u nxjerrë të këtij
22 materiali por më pak.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

24 Shoh që Mbrojtja, ekipet e Mbrojtjes nuk kanë parashtime
25 të tjera në lidhje me këtë pikë atëherë do të kalojmë tek

1 njoftimi i rregullit 102(3) dhe materialit provues.

2 Kërkoj nga palët që të na japin një farë përditësimi në
3 lidhje me progresin e arritur në nxjerrjen e materialeve të
4 kësaj rregulle, veçanërisht në qoftë se Mbrojtja ka kërkuar
5 apo do të kërkojë nxjerrjen e materialeve të rregullit 102(3)
6 në bazë të njoftimit të këtij materiali deri më datën 24
7 shtator 2021.

8 Nga parashtimet e ZPS-së, shoh që tashmë janë bërë pesë
9 kërkesa, nga Mbrojtja tre prej tyre janë zgjidhur kurse dy
10 kanë mbetur pa zgjidhur.

11 Gjithashtu nga parashtimet e z. Krasniqi e kam të qartë
12 se Mbrojtja e tij nuk do të jetë e gatshme që t'i bëjë të
13 gjitha kërkesat në lidhje me materialet që lidhen me njoftimin
14 e rregullit 102(3) deri më datën 24 shtator 2021. Mbrojtja e
15 Krasniqit parashtroi se ky afat në parim duhet të jetë pas
16 datës së fundit për nxjerrjen e materialeve të rregullit
17 102(1)(b) nga ana e Prokurorisë dhe ky afat nuk është para
18 datës 27 shtator 2021. Vetëm pas këtij afati Mbrojtja mund të
19 ketë mundësinë për ta përpunuar këtë material të nxjerrë.

20 Së fundi, dua të di në qoftë se Mbrojtja ja ka bërë të
21 ditur apo do t'ia bëjë të ditur ZPS-së se dokumentet nga
22 njoftimi se për të cilat dokumente përkatëse kërkohen hollësi
23 të mëtejshme në përputhje me vendimin tim dhe kërkesat e
24 Mbrojtjes për ndryshimin e njoftimit sipas rregullit 102(3).

25 Urdhëro, znj. prokurore.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

2 Kemi marrë deri tani shtatë kërkesa në lidhje me
3 materialin e rregullit 102(3), tre prej këtyre kërkesave janë
4 përpunuar dhe janë nxjerrë si objekt i kërkesës për masa
5 mbrojtëse të dorëzuar më 24 gusht.

6 Materialet në lidhje me kërkesat e dy të tjerave që nuk
7 janë zgjidhur po rishikohen dhe përpunohen. Presim që këto
8 materiale t'i nxjerrim në ditët në vijim dhe këto lidhen me dy
9 kërkesat e Mbrojtjes Veseli 444.

10 Dy kërkesa të tjera i kemi marrë nga ekipi i Mbrojtjes së
11 Thaçit sot. Njëra prej tyre ka të bëjë me 440 dokumente dhe
12 tjetra me 2649. Kjo është një kërkesë që lidhet me dokumente
13 më të shumta për nga sasia dhe ne duhet të shikojmë njëherë në
14 qoftë se materiali i kërkuar do të mund të nxirret brenda
15 afateve të parapara.

16 Kemi marrë parasysh edhe udhëzimet dhe afatet në lidhje
17 me ndryshimin e përshkrimeve në njoftimin sipas rregullit
18 102(3).

19 Nuk jemi për momentin të gatshëm të parashikojmë vëllimin
20 e kërkesave të tjera që do të merren, mirëpo me sa duket
21 nxjerrjet e materialit të rregullit 102(3) kanë të bëjnë me
22 materiale të shumta dhe kërkojnë punë -- angazhim në muajt në
23 vijim.

24 Edhe pse këto kërkesa janë marrë në vazhdimësi, ne presim
25 që të marrim kërkesa për materiale të shumta dhe në dritën e

1 kësaj presim -- parashikojmë se do të kërkojmë zgjatjen e
2 afateve.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
4 prokurore.

5 Z. Kehoe.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit. Ne, të katër ekipet,
7 po bashkëpunojmë në mënyrë që të përpilojmë një listë të
8 përbashkët dhe të mos përsëritim kërkesat e njëjta.

9 Dhe dhënia e njoftimit paraparak lidhet me argumentin tim
10 që e bëra pak më përpara në lidhje me nxjerrjen e dokumenteve
11 të shumta. Pra, si mund të presim tani nxjerrje të dokumenteve
12 si mbas një rregulle tjetër kur ende s'kemi pasur mundësinë që
13 të rishikojmë dhe përpunojmë dokumentet e nxjerrjes të
14 dokumenteve si mbas një rregulli tjetër.

15 E kam të qartë se Mbrojtja e z. Krasniqi ju ka kërkuar që
16 ta zgjatni afatin për ta dhe ne, si ekip Mbrojtjeje,
17 mbështesim atë kërkesë dhe sigurisht do të kërkojnë edhe
18 ekipet e tjera.

19 Duhet të vazhdojmë me nxjerrjen e këtyre materialeve mos
20 të presim më momentin e fundit. Mirëpo në kuadër të sistemit
21 të nxjerrjes së materialeve që momentalisht po i përdorim,
22 mendoj që këto afate të nxjerrjeve nuk janë reale.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

24 Dhe unë pajtohem me ju, se kërkesat duhet t'i çoni në
25 vazhdimësi mos prisni më momentin e fundit. A keni parasysh

1 ndonjë afat që brenda të cilit do të jeni të gatshëm t'i
2 dorëzoni të gjitha kërkesat? P.sh., a ju duhen edhe gjashtë
3 javë tjera, dy javë të tjera, gjashtë muaj, dy muaj dhe kështu
4 me radhë?

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne u këshilluam me Prokurorinë
6 lidhur me këtë pikë sot në mëngjes. Unë nuk mund t'ju them një
7 datë të saktë, t'ju them mbas gjashtë javëve apo mbas dy
8 muajve. Në qoftë se do marrim njoftimin e rregullit 102(3)
9 brenda 1 nëntorit dhe do të kemi informacion tjetër lidhur me
10 përkthimet, atëherë, do të mund edhe t'ju them në qoftë se do
11 të kërkojmë zgjatjen e afateve kohore në lidhje me kërkesat e
12 Mbrojtjes.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

14 Z. Emmerson urdhëroni.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shkurtimisht.

16 Prokuroria ka vonuar procesin e nxjerrjes së materialeve
17 në mënyra të ndryshme dhe kjo është njëra prej tyre.

18 Materiali sipasrregullit 102(3) është material që
19 Prokuroria e ka dhe që e gjykon të rëndësishëm. Na është dhënë
20 një indeks dhe për ne është e pamundur që ta kuptojmë
21 përmbajtjen e atij indeksi, ka rreth 68 700 shënime. Ne, si
22 ekipe të Mbrojtjes, jemi marrë vesh që këtë listë të 67 000
23 apo 68 700 shënimeve t'i ndajmë mes veti në mënyrë që ta dimë
24 se për të cilat do të duhen përshkrimet të mëtejshme më të
25 hollësishme.

1 Shpresoj se e keni të qartë, i nderuar Gjykatës, se ne,
2 si ekipe të Mbrojtjes, qëndrimi i jonë standard është që të
3 kërkojmë zgjatjen e secilit afati se si ndryshe mund ta dimë
4 se kemi një material që mund të jetë shumë i rëndësishëm për
5 Mbrojtjen. Në lidhje me këtë indeks p.sh., në ndonjërin shënim
6 përmendet emri i klientit tuaj dhe ndoshta në lidhje me atë
7 shënim do të duhet përshkrim i mëtejshëm.

8 Por bëhet fjalë për 70 000 e më shumë shënime dhe nuk
9 dimë se për sa prova flasim. Ne kemi për detyrë, si
10 profesionistë, që të kërkojmë zgjatjen e afateve kurse detyra
11 e Prokurorisë është që t'i nxjerrë provat që do t'i përdorë në
12 çështjen e vet. Dhe përsëri ndodhemi në një situatë që ata nuk
13 bëjnë nxjerrjen e materialeve deri në momentin e fundit dhe
14 nuk na tregojnë se për sa materiale ende duhet të presim.

15 Dhe për ne, si Mbrojtje, na lënë të merremi me 70 000
16 shënime në një indeks dhe sa për Prokurorinë tani ne
17 parashtrojmë pyetjen: a e ka lexuar këtë material apo jo?
18 Atëherë pse nuk na jep një përshkrim më të mirë të këtij
19 materiali të përmendur në këto 70 000 shënime?

20 Thjesht ju ftojme si Gjykatës që t'ia parashtroni këtë
21 pyetje Prokurorisë dhe t'i pyetni haptazi në qoftë se e kanë
22 lexuar këtë material? Atëherë nëse po, pse nuk e kanë
23 përshkruar më hollësisht, nëse jo, pse nuk e kanë lexuar? Ne,
24 si Mbrojtje, duhet ta ndajmë punën tonë në mënyrë që ta dimë
25 sesi t'ia parashtrojmë pyetjet Prokurorisë në lidhje me këto

1 shënime dhe ta bëjmë në një mënyrë punën që -- një punë që
2 është dashtë ata vetë ta bëjnë.

3 Deri tani unë nuk kam parë një sjellje kaq joprofesionale
4 nga një Prokurori.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.
6 Z. Young.

7 Z. YOUNG: [Përkthim] Unë e mbështes tërësisht atë që tha
8 z. Emmerson. Thjesht për të mbështetur atë që sapo tha z.
9 Emmerson, se çfarë di Prokuroria për provat e veta dhe sa
10 analizë i kanë bërë dhe çfarë vlerësimi bëjnë lidhur me
11 materialet që zbulojnë.

12 Për shkak të pandemisë dhe unë e kuptoj këtë, pjesa më e
13 madhe e punonjësve të Prokurorisë punojnë në distancë, mbase
14 unë e dëgjova gabim znj. prokurore, po unë, mua mu duk sikur
15 ju tha juve që pjesa më e madhe e personelit nuk kishte qasje
16 në databazë.

17 Tani, nëse kjo është e saktë dhe, nëse unë nuk e kam
18 dëgjuar gabim, kjo është një mënyrë shumë e thjeshtë për të
19 kuptuar se pse ato nuk i kanë bërë këto kategorizimin,
20 nënkategorizime dhe si i bëjnë këto vlerësime për
21 kategorizimin. Sigurisht, mund të përdoret inteligjenca
22 artificiale dhe që është një gjë e mrekullueshme, por në fakt,
23 kjo kërkon që të jenë persona realë ata që të marrin
24 vlerësimet në bazë të gjykimit të tyre profesional.

25 Nëse Prokuroria nuk ka qasje në këto materiale atëherë

1 kjo mund të jetë një arsye tjetër e fortë pse ne po hasim në
2 kaq shumë vonesa të konsiderueshme.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

4 Znj. Alagendra. Z. Ellis, ju lutem.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kjo është një
6 nga problemet që do të ngrija dhe unë.

7 Ju besoj keni parë në parashtimet tona me shkrim dhe
8 është se ne kërkojmë një shtyrje të afatit për të kërkuar
9 materiale për njoftimin të rregullit 102(3). Ka një bazë kjo.
10 E para e punës është materiali shumë i madh i materialeve të
11 listës, 68 000 dokumente. Vetë lista është qindra faqe. Dhe
12 duke pasur parasysh edhe kohën, burimet e nevojshme që duhen
13 për t'u përgatitur dhe mocionet paraprake është një proces që
14 ha shumë kohë në vetvete.

15 Së dyti, dhe mbase është edhe më e rëndësishmja kjo që do
16 them tani, është që vlerësimi i materialitetit lidhet me
17 shqyrtimin e nxjerrjeve që na bën Prokuroria.

18 Për të dhënë një shembull të kuptueshëm: nëse një
19 dokument përshkruhet në njoftim duke përmendur emrin e një
20 individi të veçantë, ne mund të mos ta dimë në atë moment nëse
21 ky individ është me rëndësi apo jo për hetimet tona. Ne vetëm
22 mbasi të kemi pasur mundësinë që të shikojmë me imtësi
23 materialet e nxjerra dhe për të parë se cili është
24 materialiteti i këtij individi në paketën e nxjerrë atëherë
25 mund të të bëjmë një vlerësim të materialitetit.

1 Prandaj dhe unë mendoj, se parashtrimi i avokatit të z.
2 Thaçi ishte i saktë për të bërë një pezullim dhe jo një
3 shtyrje të afatit sepse, sipas mendimit tim, unë nuk jam në
4 gjendje që të jap një vendim përfundimtar nëse këto dokumente
5 janë materiale apo jo deri në momentin kur Prokuroria të ketë
6 përfunduar nxjerrjen e materialeve. Dua të them derisa të kemi
7 marrë përkthimet e të gjitha materialeve të rregullit
8 102(1) (b) .

9 Pra, edhe përpara se të flasim për afatet tona neve do të
10 duhet të jemi të sigurtë me Gjykatën duke pasur parasysh
11 gjithë materialin e nxjerrë dhe vëllimin e materialit që është
12 në listë do të na duhet muaj e muaj derisa të marrim këto
13 përkthime, nuk është më punë ditësh.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

15 Përpara se t'ia jap fjalën Prokurorisë, dua të dëgjoj
16 ekipet e Mbrojtjes për afatin që kam vendosur në vendimin tim
17 me numër F460, mbi kërkesën e Mbrojtjes për njoftimin, pra,
18 afati i 24 shtatorit, nëse nuk e kam gabim, për t'i kërkuar
19 ZPS-së që ta plotësoj njoftimin. Dua t'ju pyes ky ju duket
20 afat i realizueshëm apo edhe për këtë afat doni shtyrje sepse,
21 nëse ju kujtohet, në vendim unë vendosa dy regjime të
22 ndryshme: në njërin ju mund ta konsideroni të mjaftueshëm
23 informacionin e njoftimit siç është; dhe një tjetër për
24 materiale të cilat ju mendoni se s'ka informacione të
25 mjaftueshme dhe ju duhet më shumë.

1 Unë e vendosa datën 24 shtator si afat ku Mbrojtja t'i
2 kërkonte ZPS-së që ta plotësonte njoftimin. Të gjitha ekipet e
3 Mbrojtjes kanë folur për afatet për të kërkuar vetë dokumentet
4 por për t'ju drejtuar ZPS-së për ta plotësuar njoftimin data e
5 24 shtator a është e realizueshme apo edhe për këtë afat
6 kërkon shtyrje?

7 Z. Kehoe, fjala është për ju.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, i nderuar
9 Gjykatës, por unë i përfshijsa të dyja këto probleme së bashku.
10 Në emër të z. Thaçi kërkojmë një shtyrje të këtij afati, të
11 afatit për të plotësuar nxjerrjen.

12 Siç e tha me të drejtë z. Emmerson, bëhet fjalë për një
13 vëllim shumë të madh materiali dhe një perëndi e di sesa
14 informacione na duhet që të shqyrtojmë. Prandaj kërkojmë
15 shtyrje të të dy afateve.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. Emmerson.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kur thashë që ekipet e Mbrojtjes
19 po bashkëpunojnë, kjo është në lidhje për të konstatuar se
20 cilat pjesë të 68 000 materialeve kishin nevojë për më shumë,
21 pra, jemi munduar që t'i zbërthejmë këto në bazë të asaj që ka
22 një interes, të paktën një interes të përbashkët, për të parë
23 nëse përshkrimi i dokumentit është i mjaftueshëm për të
24 kuptuar përmbajtjen.

25 Por, të jeni të sigurtë për këtë, Mbrojtja i ka bërë

1 kërkesat. Ne i kemi bërë kërkesat për dokumente në emër të z.
2 Veseli. Po besoj se edhe ekipet e tjera të Mbrojtjes kanë bërë
3 të njëjtën.

4 Pra, çdo gjë tjetër, hë për hë, kërkon një analizë të
5 mëtutjeshme dhe ne po na kërkohet që të bëjmë punën që duhet
6 ta bënte Prokuroria.

7 Unë ndihem në siklet, domethënë, kur i kërkohet Mbrojtjes
8 që të kërkojë shtyrje të këtij afati se një Prokurori e
9 ndershme, e drejtë nuk paraqitej para Gjykatës me 68 000
10 dokumente të listuara ku disa prej tyre përmendin dhe persona
11 që s'kanë asnjë kuptim për ne dhe thonë "ja ku i keni" edhe le
12 të na thotë Mbrojtja tashi përse i duan këto dokumente?

13 Pra, na kërkohet neve që të bëjmë punën e Prokurorisë. E
14 kam thënë që në fillim të këtij procesi, ku ju na keni kërkuar
15 në qoftë se ju kujtohet që të vendosnim një listë apo një
16 grafik kohor dhe thashë "jo nuk e bëjmë këtë punë, është e
17 detyra e Prokurorisë". Prokuroria duhet të jetë e gatshme për
18 të shkuar në gjyq. Çfarëdo lloj gjëje që mund të thuhet për
19 Prokurorinë sa herë që fillojnë ata, për çdo gjë që duhet ta
20 bëjnë ato, gjithmonë kanë pësuar defekte dhe ky është një
21 problem që të kërkon zgjidhje të menjëhershme.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young, pra, kemi këtu dy
23 afatet të përbashkëta.

24 Z. YOUNG: [Përkthim] Unë s'kam asgjë për të thënë thjesht
25 mbështes ato që tha z. Kehoe dhe z. Emmerson.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z.Young.

2 Z. Ellis.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk mendoj se
4 ka ndonjë gjë për të shtuar nga ana ime. Edhe unë u bashkohem
5 parashtrimeve të mëparshme.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Znj. prokurore.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jemi në dijeni, sigurisht, që ka
9 një vëllim shumë të madh të materialeve të listuara në këtë
10 njoftim. Kjo përputhen dhe me natyrën dhe fushëveprimin e
11 kësaj çështjeje si me shtrirjen gjeografike, ashtu edhe me
12 parametrat e tjera. Nuk kemi komente lidhur me ato që ka thënë
13 Mbrojtja.

14 Një sqarim, mbase mund ta bëj. Unë nuk thashë që
15 personeli nuk i ka shqyrtuar materialet. Unë thashë që nuk
16 kanë pasur qasjen në databazën e centralizuar. Por na është
17 dashur që të gjejmë zgjidhje të tjera që shqyrtimin ta bëjnë
18 njerëzit dhe jo kompjuterët. Kjo ka qenë vërtetë një sfidë për
19 ne dhe na e ka zgjatur kohën.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim]

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, ju lutem.
22 Fjalën jua jap unë. Nëse dëshironi ta merrni fjalën duhet të
23 ma kërkonit mua, s'duhet t'i drejtoheni Prokurorisë.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, unë në fakt, u ngrita në
25 këmbë që më jepnit fjalën për një gjë shumë të shkurtër.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë e keni fjalën për
2 të folur shumë shkurt.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Për trajtuar debatin midis z.
4 Young dhe Prokurorisë, forma e fjalëve që u përdor është që
5 Prokuroria ka kryer një shqyrtim të madh ku personeli ka
6 punuar në distancë, pra, jo në zyrë, një detyrë shumë e madhe
7 nga ana logjistike.

8 Kjo u tha, kjo është thënë që në seancën e parë nga
9 Mbrojtja sesi do të zhvillohesh ky proces. Të gjitha këto
10 ishin të parashikueshme dhe Prokuroria tregon dhe Prokuroria
11 kurdo që të ngrehi aktakuzë atë e kanë marrë vendimin që kur
12 të mbajnë njerëzit në paraburgim, pra, kur ato kanë arrestuar
13 dhe kanë futur në paraburgim persona kur ata ishin me vite
14 larg të qenurit gati për gjyq.

15 Të gjitha këto janë justifikime dhe sinqerisht, është e
16 jashtëzakonshme që prokurorja ngrihet edhe përdor si
17 justifikim pandeminë e Corona virusit, kur që në fillim kjo
18 dihej ishte e dukshme. Ne i kemi thënë në seancë të hapur dhe
19 ju ju dha premtim nga Prokuroria që duhet të ishin gati deri
20 tani.

21 Unë ende, unë ju kërkoj që t'i kërkon Prokurorisë ose të
22 shpjegohet ose të kërkojë ndjesë për këtë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. prokurore dëshironi të
24 përgjigjeni?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo. Nuk mendoj se kam ndonjë gjë

1 për të shtuar lidhur me këtë. Faleminderit.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Mirë, faleminderit.

3 Kalojmë shumë shkurt, shpresoj, në dy pikat e fundit sa i
4 takon nxjerrjes. Materiali i rregullit 103.

5 Dua që të di nëse ka ende prova shfajësuese në zotërim,
6 kontroll apo dijeni faktike të Prokurorisë që duhet t'i
7 nxirren Mbrojtjes në përputhje me rregullën 103 dhe nëse do të
8 bëhen kërkesa për masa mbrojtëse për një material të tillë.

9 Znj. prokurore keni fjalën.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Pas konferencës së fundit, pesë
11 paketa janë nxjerrë me materiale mundësisht shfajësuese, duke
12 përfshirë dhe paketën e fundit numër 83.

13 Po shqyrtohen materiale të tjera për të parë nëse ka dhe
14 do të vijojmë që të nxjerrim materiale herë pas here me t'u
15 identifikuar. Dhe ende nuk jemi në dijeni të ndonjë kërkesë
16 për masë mbrojtëse lidhur me këtë material.

17 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
18 prokurore.

19 Z. Kehoe.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky është një problem që unë e kam
21 parë faktikisht duke pasur parasysh edhe procesin e nxjerrjeve
22 dhe unë nuk dua që jap fjalën se i kam shqyrtuar të gjitha
23 këto materiale që kemi marrë deri tani që janë një sasi e
24 madhe.

25 Por kam pritur që t; marrim material nga dëshmitarë

1 ndërkombëtarë po nuk janë shumë në fakt. Është e çuditshme
2 duke pasur parasysh kohën që klienti im ka pasur me, le të
3 themi, me forume ndërkombëtare, institucione ndërkombëtare e
4 kështu me radhë.

5 Jam i shqetësuar pse nuk po na i nxjerrin. Nuk po na i
6 nxjerrin se nuk janë të dobishme për Prokurorinë edhe i kam
7 parë kështu me mirësi apo mbase këto materiale e zbusin, le të
8 themi, fajësinë e klientit apo ajo që është më e rëndësishme
9 cenojnë kredibilitetin e një dëshmitari ndërkombëtar.

10 P.sh., nëse një diplomat i Shtetet të Bashkuara të
11 Amerikës që ka qenë në vend apo ka qenë në NATO dhe i përdor
12 Shtetet e Bashkuara të Amerikës si shembull, mund të jetë një
13 diplomat i cilito vendi dhe ky person do të dëshmojë për një
14 aspekt dhe në fakt, ka telegrame, raporte të cilat i cenojnë
15 ato që do të thotë ky dëshmitar apo janë ndryshe nga fjalët e
16 dëshmitarëve edhe ky është material i rregullës 103. Pra, nuk
17 janë thjesht materiale shfajësuese apo lehtësuese. Janë dhe
18 materialet që cenojnë kredibilitetin e dëshmitarit të
19 Prokurorisë.

20 Dhe shqetësimi që kam unë, me mungesën e këtyre
21 telegrameve që nuk na janë nxjerrë, është se unë shoh persona
22 të huaj në listën e dëshmitarëve, por shumë pak telegrame nga
23 vendet e tyre të cilat mund të ishin pjesë e kategorive të
24 ndryshme dhe sigurisht, cenojnë dhe kredibilitetin e
25 dëshmitarit në fjalë. Në fakt, është shumë e rëndësishme, kjo

1 është shumë e rëndësishme për z. Thaçi, sepse z. Thaçi ka
2 punuar shumë në nivel ndërkombëtar, në fushën ndërkombëtare ka
3 punuar me udhëheqës ndërkombëtarë.

4 Pra, bëhet fjalë për një kërkesë, sipas rregullës 107,
5 sepse nuk mund të nxirret me lejen e vendit përkatës, por
6 duhet bërë kjo kërkesë, të bëhet kjo kërkesë për të parë që
7 ne, më falni, të shikojmë çdo gjë që çka parë dhe Prokuroria.
8 Kjo është mënyrë më e lehtë.

9 Pra, shembull, telegramet që janë, telegramet diplomatike
10 të Francës p.sh., të na nxirren dhe ne për t'u siguruar që e
11 cenojnë apo jo kredibilitetin e dikujt apo mbase e mbështesin
12 apo jo qëndrimin e mbajtur nga Z. Thaçi në këtë gjykim.

13 Pse e ngre këtë çështje, i nderuar Gjykatës? Me këtë
14 mungesë të telegrameve diplomatike, unë dua të sigurohem që
15 Prokuroria e ka zgjeruar shqyrtimin e rregullit 103 për të
16 parë se mos ka ndonjë gjë që jo vetëm që ka në kontroll po
17 edhe që ka në dijeni që ky informacion ndikon në
18 kredibilitetin e dëshmitarit të tyre.

19 Këtë kërkesë e bëj, i nderuar Gjykatës, për t'i kërkuar
20 Prokurorisë, -- që ju t'i kërkon Prokurorisë që të nxjerrë të
21 gjithë këtë informacion. Këto telegrame diplomatike, ky
22 letërkëmbim diplomatik i të gjitha vendeve, që mund të bëhet
23 edhe sipas rregullit 107, sepse unë e kuptoj që materiali i
24 rregullit 103 është objekt i rregullit 107 dhe 108, të bëhet
25 kjo kërkesë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Nëse ju kuptova qartë, ju i kërkon Prokurorisë që të
3 ndjekë një shqyrtim proaktiv të materialit shfajësues, jo
4 vetëm që kanë zotërim apo në kontroll, por edhe që të qëmtojnë
5 apo që të kërkojnë dokumente nga shtete apo organizata
6 ndërkombëtare për të vlerësuar nëse ka material shfajësues në
7 këto dokumente. Kështu?

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo do të ishte idealja. Por ajo që
9 unë kam më shumë shqetësim, i nderuar Gjykatës, është se a ka
10 ndonjë tërësi materiale, a ka marrë informacion Prokuroria
11 dhe ato kanë përzgjedhur dokumente që do t'i përdorim pra, apo
12 që nuk do t'i përdorin në provat e tyre.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, kërkesa juaj është e
14 dyfishtë. Së pari është një përmbledhje e dokumentacionit që
15 ato kanë në zotërim, pra, ky është një shqyrtim më i
16 përgjithshëm sipas rregullës 103 dhe një shqyrtim proaktiv
17 nëse mund ta them kështu?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Si punonjës i Gjykatës do t'ju çoja
19 përsëri tek kjo çështje. Në qoftë se ata e dinë, rregulli
20 thotë shumë qartë, që është në njohurinë apo në kontrollin e
21 tyre.

22 Në qoftë se është në kontrollin e tyre është pjesa më e
23 lehtë. Po ta mbani p.sh., që ata kanë një mori dokumentesh
24 disa i lexojnë, disa i lënë aty. Në qoftë se, në fakt, ata që
25 ato që ata vendosin të mos i marrin lidheshin me dëshmitarët

1 pra, është diçka që ata e dinë por që ne, sipas rregullit 103,
2 kemi të drejtë ta dimë, duke ju nënshtruar rregullit 107.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Për të qenë të qartë, këtë duhet
5 ta trajtojmë veçan, por është pa diskutim një mbivendosje
6 midis rregullit 103 dhe materialeve të rregullit 102(3).

7 Në qoftë se ju kujtohet, unë e ftova Prokurorinë të na
8 vërë në dukje nëse i kanë lexuar 68 000 dokumentet? A e dinë
9 ata se ç'përmbajnë ato? Nëse nuk e dinë, përgjigja është se
10 ato dokumente nuk janë lexuar, atëherë Prokuroria nuk i bën
11 dot, nuk i realizon dot detyrimet e veta lidhur me materialet
12 shfajësues.

13 Pa u futur në hollësi, unë e di që në atë listë ka
14 materiale që janë shfajësuese dhe duhet të futen në listën e
15 materialeve shfajësuese. Është e qartë që ata nuk e kanë bërë
16 punën e tyre. Prandaj duhet të këmbëngul përsëri që Prokuroria
17 të pyetet, të thotë zyrtarisht nga këto 68 700 faqe, cilat
18 dokumente i ka lexuar dhe i kanë analizuar për të parë
19 rëndësinë e tyre.

20 Dhe sot duam përgjigjen se ata e dinë përgjigjen. Dhe
21 duhet ta thonë. Nëse përgjigja është "jo", atëherë e kemi
22 punën pisk lidhur me këtë gjyq.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

24 Z. Young, të lutem.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] për të njëjtën

1 pikë.

2 Siç e dini, Prokuroria sapo ju tha se janë duke parë
3 materialet e rregullit 103 apo mundësisht shfajësues dhe
4 shqyrtimi vazhdon. Siç e dini, i nderuar Gjykatës, janë
5 materiale shumë të rëndësishme sepse lidhen me pafajësinë e të
6 akuzuarve apo me minimin e çështjes së Prokurorisë të
7 dëshmitarëve. Pra, nuk ka si të bëhet më e rëndësishme si
8 kategori.

9 Duke u mbështetur tek këto që tha Emmersoni, unë them me
10 respekt se ka shumë rëndësi, që ju dhe palët, sidomos Mbrojtja
11 dhe të akuzuarit të kenë një ide për vëllimin e materialeve që
12 Prokuroria ka identifikuar si material që duhet ta nxjerrin
13 për ta shqyrtuar nëse futet në rregullin 103.

14 Kjo lidhet drejtpërdrejtë me procedurat. Pra, ne duhet të
15 kemi një ide. Po flasim për një apo për dy dokumente apo për
16 mijëra dokumente apo dhjetëra-mijëra dokumente? Ato i kanë
17 identifikuar materialet që duhet të shqyrtojnë, prandaj
18 përgjigja për këtë pyetje do të ishte me dobi.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

20 Z. Ellis apo znj. Alagendra.

21 Znj. Alagendra mikrofonin, ju lutem.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Z. Ellis
23 do t'i përgjigjet. Ju kërkoj ndjesë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jeni shumë në Zoom dhe ju
25 shoh me pamje shumë të vogla dhe ndonjëherë e kam të vështirë

1 të dalloj se cili prej jush do t'i përgjigjet pyetjes.

2 Z. Ellis.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk ja vlente
4 ta pyesnit për mua se dhe u bashkëngjitëm mendimit të
5 kolegëve.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Gjithmonë është me vlerë z.
7 Ellis.

8 Tani i drejtohem Prokurorisë. Ka disa pyetje që ka bërë
9 Mbrojtja.

10 E para, ka të bëjë me konceptin e njohurisë konkrete
11 lidhur me rregullin 103. Pyetja e dytë, ka të bëjë - shqyrtimi
12 i materialeve të rregullës 103 është bërë për tu siguruar që
13 ka materiale të rregullit 102(3) në listë të cilat duhet të
14 ishin nxjerrë veçantë dhe pastaj pyetja është lidhur me
15 vëllimin e materialeve të rregullit 102(3).

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më falni, të ndërhyj. Pyetja që u
17 bëra, që ta pyesni dhe nuk e di pse ju e bëtë qëllimisht
18 ndryshe, unë ju kërkoja, konkretisht, që të pyesni a e ka
19 lexuar Prokuroria secilin prej dokumenteve të listës 103, pra,
20 a e ka parë mendja e njeriut gjithë këto dokumente për 68 700
21 për të përcaktuar nëse aty përmbahen dokumente të rregullit
22 103?

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju dëgjova z. Emmerson.

24 Znj. prokurore keni fjalën.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

1 Në lidhje me kabllo të përcaktoi Mbrojtja e z. Thaçi që
2 kanë interes për të, ne kemi mbajtur shënim. Besoj që disa
3 kabllo janë nxjerrë, të tjerat janë listuar si në njoftimin si
4 mbas rregullit 102(3).

5 Në qoftë se Mbrojtja e Thaçit synon që të bëjë një
6 kërkesë në bazë të rregullit 102(3) lidhur me kabllo apo
7 mendon se e ka bërë një gjë të tillë, mund të diskutojmë me ta
8 pas seancës.

9 Në lidhje me pyetjen që bëri Mbrojtja e z. Veseli, për
10 materialët e rregullit 102(3), a janë parë ato për rëndësinë e
11 tyre. Identifikimi i materiale i shfajësuese kërkon një
12 ushtrim më të thelluar dhe është në vazhdim e sipër. Ekipet e
13 Mbrojtjes kanë të drejtë që mund të ketë materiale
14 informacione sipas rregullit 102(3) në këtë listë dhe kjo
15 është për shkak se shqyrtimi po vazhdon. Nuk kemi pretenduar
16 deri tani se e kemi përfunduar këtë punë.

17 Por, në rregull, në rastin e kësaj natyre parashikojmë që
18 një sasi e madhe materiale lidhur me rregullin 102(3) mund
19 të lidhet me çështje potencialisht shfajësuese si ato të
20 materialeve që janë nxjerrë. Tani, nuk po sugjerojmë që kjo
21 është më pak detyrim për ne për të nxjerrë materiale të cilat
22 po i shqyrtojmë dhe do t'i nxjerrim. Por thjesht desha të vija
23 në dukje, se mund të mos ketë shumë materiale shfajësuese të
24 reja.

25 Përveç dhe gjithashtu, siç tha ekipi i z. Thaçi, disa

1 materiale lidhen me dëshmitarë dhe mbrojtje që është përdorur
2 nga ne. Pra, ne do të vazhdojmë të analizojmë derisa të
3 finalizojmë listën e dëshmitarëve dhe të dëshmimeve.

4 Besoj se me këtë iu përgjigja pyetjeve. Në qoftë se kam
5 harruar diçka me kënaqësi do t'i përgjigjesha.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Është fjala për vëllimin e
7 materialeve të rregullit 102(3).

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kam e kam numrin përpara të
9 materialeve. E di që është një kategori materialesh që është
10 identifikuar që kërkon shqyrtim në bazë të rregullit 102(3), e
11 di që kohët e fundit kemi marrë materiale që nuk i është
12 nënshtruar shqyrtimit tonë në të dy kategoritë, por nuk e kam
13 numrin lidhur me vëllimin e tyre.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë thashë vëllimi i
15 102(3), faktikisht është materialet e rregullit 102(3).

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Znj. Lawson nuk i përgjigjet dot
17 pyetjes, sigurisht, sepse sapo tha që nuk i ka shqyrtuar
18 efektivisht 68 700 dokumente për të parë materialet
19 shfajësuese.

20 Por, ju siguron, se do të jetë besoj e njëjta gjë si me
21 materialet e tjera shfajësuese. Nga e di ajo kur s'e ka parë?
22 Ku e mbështet ajo këtë vlerësim, këtë parashtrim? Kur nuk e
23 kanë bërë ende analizën apo shqyrtimin? Këtë kisha parasysh që
24 Prokuroria e keqpërfaqëson çështjen. Bëhet fjala për 68 700
25 dokumente që, ajo e pranon, mund të përmbajnë materiale të

1 rregullit 103, por ajo nuk ka ide se cilat janë ato.

2 A e kuptoni se çdo të thonë? I gjithë diskutimi që kemi
3 zhvilluar është humbje kohe sepse është një vëllim materiale
4 që mund të përmbajë shumë materiale shfajësuese që as nuk i
5 kanë parë me sy. Pra, është përfshirë disi elementi njeri po
6 aq sa për të dhënë një përshkrim të duhur.

7 Por ajo që ka më shumë rëndësi, ju e thatë, që tha me
8 plot gojën që shqyrtimi i materialeve shfajësues nuk është
9 bërë ende. Me fjalë të tjera, siç sapo tha, me terma shumë të
10 qarta edhe mund të ketë materiale shfajësues në këtë, në listë
11 me 70 000 dokumente.

12 Në qoftë se ky është qëndrimi i Prokurorisë, atëherë, si
13 mund të mbështetemi ne në mbylljen e çështjes së Prokurorisë?
14 Ne jemi Mbrojtja dhe na kërkohet të shqyrtojmë materialin kur
15 Prokuroria vetë as që e ka parë fare dhe na e hedhin ne
16 barrën. Diçka është seriozisht keq nuk shkon këtu. Prandaj
17 thashë ajo se pëlqen që unë përdor këtë gjuhë, do që të përdor
18 një gjuhë të sjellshme, nuk i pëlqen që unë them "keqpërdorimi
19 çështjes nga Prokuroria". E thotë që mund të jenë materiale të
20 njëjta se ato që kemi nxjerrë, kur në fakt, si kam parë fare.
21 Nuk ka bazë faktike për parashtrimin e saj.

22 Nga përvoja ime, nga juridiksionet nga ku vij unë, kjo
23 është sjellje e keqe e Prokurorisë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe, shkurtimisht, ju
25 lutem.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Materialet e rregullit 103 qëndrojnë
2 më vete. Ky rregull qëndron më vete. Po, ka një pjesë të këtij
3 rregulli që ka të bëjë me dënimin, ndëshkimin e dëshmitarëve
4 por, aty ka një detyrim që qëndron më vete lidhur me
5 materialet shfajësuese. Pra, është një detyrim i vetëm që
6 qëndron më vete.

7 Parashtrimi im për kabllot, nuk është se nuk na janë
8 dhënë kabllot po s'na kanë dhënë aq sa duhet, për ne që kemi
9 jetuar në këtë botë, e dimë që kabllot shkëmbehen dhe të cilat
10 mund të kenë një kuptim të rëndësishëm për klientët e mi. Aty
11 mungesa e kablllove tregon që ka më shumë kablllo të cilat ose
12 nuk më janë nxjerrë ose Prokuroria nuk mendon se kanë rëndësi
13 për çështjen e tyre. Dhe nuk e shohin si material 103. Ne duam
14 të shikojmë pikërisht këtë material. Pra, unë do të doja që ju
15 t'i urdhëronit ata të na i jepnin këto dokumente.

16 GYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. prokurore, dëshironi
17 të përgjigjen i për këtë? Nëse, ju lutem, shkurt.
18 Faleminderit.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shumë shkurt.

20 Unë nuk thashë që nuk janë nxjerrë të gjithë materialet,
21 vetëm disa edhe thashë se rishqyrtimi jonë po vazhdon.

22 GYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I kthehem përkthyesëve, në
23 më lejoni dhe pesë minuta të përfundojmë çështjen e
24 përfundimit përpara pushimit?

25 Faleminderit shumë thotë përkthyesve që të mbarojmë.

1 Kalojmë tek materialet e rregullit 107. Dua të di nga
2 palët nëse parashikojnë ndonjë vështirësi lidhur me procesin e
3 nxjerrjes të materialeve të rregullit 107 dhe nëse do të bëni
4 ndonjë kërkesë që lidhet me këtë rregull.

5 E di që e prekëm këtë kategori kur folëm për të tjera, po
6 a keni për të shtuar diçka lidhur me materialet e rregullës
7 107?

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kam shumë çfarë t'i shtoj
9 parashtrimeve me shkrim. Diskutimet vazhdojnë lidhur me
10 miratimet apo me masat balancuese kompensuese. Organizatat i
11 kemi njoftuar vazhdimisht për urgjencën dhe rëndësinë e
12 çështjes dhe po punohet aktivisht për të marrë miratimet e
13 duhura.

14 Është një proces, që në shumë raste, ne po diskutojmë për
15 dokumente të veçanta rresht për rresht, këtë e bëjmë për të
16 siguruar që çdo kufizim apo redaktim që konsiderohet i
17 nevojshëm të mbetet në nivel minimal dhe në masën që kufizime
18 të tilla nuk lidhen me informacione që janë me rëndësi për
19 përgatitjen e Mbrojtjes.

20 Kemi bërë disa kërkesa, parashikojmë -- në bazë të
21 rregullit 107, parashikojmë të bëjmë të tjera në lidhje me një
22 numër çështjes duke përfshirë në kontekst të rregullit 102(3).
23 Kërkesa e të rregullës 102(3) për të pasur qasje në material.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Është një farë vrime e zezë për ne

1 kjo. Ne nuk e dimë se çfarë parashikon Prokuroria në bazë të
2 rregullit 107.

3 Pa informacione të mëtejshme, më falni, por nuk kam gjë
4 për të shtuar.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

6 Z. Emerson, ju lutem.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë po ashtu.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Young.

9 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Asgjë për të
10 shtuar.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] As ne s'kemi
13 gjë për ta.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

15 Pra, është ora 16.07. Do të bëjmë një pushim prej 30-
16 minutash, do të kthehemi në 16.37 për të diskutuar pikat
17 tjerat të programit sot. Ndërpritet seanca këtu.

18 --- Pauza fillon në orën 16.07

19 --- Seanca rifillon në orën 16.37

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani të kalojmë te pika e
21 dytë e rendit të ditës, pas asaj të nxjerrjes së materialeve.
22 Dhe pika e dytë është përkthimi i parashtrimeve i materialeve
23 provuese.

24 Së pari dua të dëgjoj nga Zyra Administrative, në lidhje
25 me përkthimin e këtyre dokumenteve, përkatësisht në qoftë se

1 njësia e përkthimeve ka një afat të llogaritur për përkthimin
2 e mocioneve paraprahe dhe në qoftë se palët kanë bërë kërkesa
3 të tjera për përkthim.

4 Përveç kësaj, theksoj parashtrimin e mbrojtjes së zotit
5 Krasniqi, se nga 684 parashtrime në anglisht, vetëm 114 janë
6 të përkthyer në shqip dhe se ngarkesa e punës vazhdon të
7 shtohet.

8 Z. STRONG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mendoj që nuk
9 dëgjoheni kur flisni.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, dëgjohej. Nuk e di në
11 qoftë se ju mund të më dëgjoni?

12 Mendoj se ka një problem teknik. Tani më dëgjoni?

13 Z. STRONG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, nga ajo që pash, nuk
15 dëgjohej në Zoom por dëgjohej në sallë të gjyqit. Zoom
16 kontrollohet nga kabina audovizuale. Tani nuk e di nëse më
17 dëgjoni?

18 Z. STRONG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, ju
19 dëgjojmë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë do të filloj nga
21 fillim, që të mos keni humbur asgjë. Thashë që do të kalojmë
22 te çështja e përkthimit të parashtrimit të materialeve
23 provuese. Thashë që dua të dëgjoj nga Sekretaria nëse është
24 arritur progres me përkthimin e disa dokumenteve përkatësisht,
25 në qoftë se njësia e përkthimeve ka një afat të përllogaritur

1 për përkthimin e vendimeve mbi mocionet paraprake dhe në qoftë
2 se palët kanë bërë kërkesa të tjera urgjente për përkthim.

3 Përveç kësaj theksoj, parashtrimet e mbrojtjes së zotit
4 Krasniqi, se nga 684 parashtrime të protokolluara në anglisht,
5 vetëm 114 janë të përkthyer në shqip dhe se ngarkesa e punës
6 vazhdon të shtohet.

7 Gjithashtu, dua të dëgjoj nga palët në qoftë se
8 parashikojnë vështirësi të tjera në lidhje me përkthimin dhe
9 në qoftë se ka parashtrime të cilave duhet t'u jepet
10 përparësi.

11 Z. Roche, urdhëroni.

12 Z. ROCHE: [Përkthim] Ju faleminderit. Në lidhje me tre
13 vendimet mbi mocionet paraprake me numrat F00412, 413 dhe 450.

14 Afati që jep njësia e përkthimit është se do të
15 përfundohen deri në 15 tetor, në varësi të ndonjë kërkesë
16 tjetër për përkthim urgjent.

17 Për sa i përket kërkesave prioritare për momentin nuk ka
18 të tilla. Njësia për administrimin e punës së Gjykatës ka bërë
19 kërkesë të gjitha ekipeve që deri më 8 shtator të bëjnë të
20 gjitha kërkesat e tyre për përkthime prioritare. Të gjitha
21 dokumentet që kërkohen sipas rregullores dhe ligjit tashmë
22 janë përkthyer dhe ne po vazhdojmë të përkthejmë sa më shpejt
23 që është e mundur. Ju faleminderit.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Roche.
25 Tani i jap fjalën mbrojtjes.

1 Z. Kehoe.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, mbrojtja e Krasniqit e ka
3 theksuar gjendjen e të gjitha ekipeve. Pra, se nga 684
4 dokumente në anglisht, vetëm 114 janë përkthyer në shqip.
5 Është e pamundur për klientët tanë që t'i lexojnë këto
6 dokumente në shqip dhe kjo ka të bëjë gjithashtu edhe me
7 dokumentet që lidhen me njoftimin për nxjerrjen sipas
8 rregullës 102(3). Ne nuk mund të japim njoftimin tonë për
9 dokumentet e rregullës 103 pa i diskutuar këto dokumente me
10 klientët tanë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Zoti Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Young.

15 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Për sa i
16 përket kërkesave për përcaktimin e përparësisë për përkthimin
17 e dokumenteve, janë bërë kërkesa të tilla por në këtë fazë kur
18 nuk e kemi të qartë rëndësinë e materialeve, ne nuk jemi në
19 gjendje të bëjmë kërkesa përkatëse por mund të them që do të
20 ketë kërkesa të tilla për përcaktimin e prioritetit dhe besoj
21 që të ketë kapacitete dhe burime që të përmbushin kërkesat e
22 përkthimit.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

24 Zonja Alagendra apo zoti Ellis?

25 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Shkurtimisht

1 në lidhje me mocionet paraprake në qoftë se përkthimi i tyre
2 merret me 15 tetor që është e premte, afatet për përgjigjet në
3 lidhje me çështjet e juridiksionit është 18 tetor. Kjo është e
4 hënë. Në qoftë se është e mundur që përkthimi i këtyre
5 mocioneve të merren më herët, atëherë zoti Krasniqi do të mund
6 të marrë pjesë në procesin e paraqitjes së përgjigjes.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, zoti
8 Ellis.

9 Atëherë nga parashtimi juaj kuptoj se kërkon nga Zyra
10 Administrative që t'i caktojë përparësi vendimit mbi
11 juridiksionin në krahasim me dokumentet e tjera.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, kjo do të
13 ishte e arsyeshme. Ne i kemi marrë emaillet e Zyrës
14 Administrative për çështjet e tjera dhe jemi në kontakt me të
15 gjitha [e pa kuptueshëm].

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

17 Zoti Roche, atëherë, a është e mundur që njësia e
18 përkthimeve t'ju caktojë përparësi vendimit të juridiksionit?

19 Z. ROCHE: [Përkthim] Do ta diskutoj këtë me njësinë e
20 përkthimeve dhe parashtimit F00412 do t'i jepet prioritet në
21 krahasim me dokumentet e tjera.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Roche, e
23 çmoj këtë angazhim. A keni diçka tjetër për të shtuar në
24 lidhje me përkthimet?

25 Z. ROCHE: [Përkthim] Jo.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë do t'i jap fjalën
2 zotit Laws për çështje e përkthimeve, si përfaqësuesi i
3 viktimave. A keni diçka për të shtuar?

4 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo nuk kam.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Laws.

6 Tani i drejtohem ZPS-së për statusin e hetimeve në
7 vazhdim e sipër, a mund të na japë një datë të përafërt për
8 përfundimin e hapave hetimorë në vazhdim e sipër në qoftë se
9 ZPS-ja është e gatshme që të japë një datë për dorëzimin e
10 dosjes paraprake dhe materialeve në lidhje me të. E di që ZPS-
11 ja nuk ka përmendur asgjë në lidhje me këtë në parashtimet me
12 shkrim. Informacion në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes së zotit
13 Thaçi, në qoftë se dorëzimi i një liste paraprake të
14 dëshmitarëve është e mundur, në bazë të rregullës 95(4)(b) dhe
15 në qoftë se, kur?

16 Gjithashtu ftoj Prokurorinë që të bëjë parashtimet në
17 lidhje me kalendarin e procedural në lidhje me këtë çështje.

18 Zonja prokurore, urdhëroni.

19 Znj. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. Në lidhje me
20 hetimet në vazhdim e sipër nuk kam shumë për të shtuar nga ajo
21 që u tha në konferencën e fundit për statusin e çështjes.
22 Mbetet detyrë e Prokurorisë që të vazhdojë hetimet, në kuadër
23 të mandatit. Ne e kemi parasysh kuadrin e zbatueshëm dhe
24 ndoshta materialet që mund të dalin nga hetimet e mëtejshme
25 mund të kërkojnë autorizime gjyqësore.

1 Për sa i përket afateve kohore, këtu duhet të merren
2 parasysh edhe rëndësia dhe paragjykimi potencial i
3 materialeve. Në lidhje me materialet e 95(4) kemi thënë gjatë
4 konferencës së fundit që i kemi parasysh faktorët që mund të
5 ndikojnë në afatet. Këtu përfshihen ballafaqimet në lidhje me
6 mocionet paraprake dhe pastaj ato argumentimet në lidhje me
7 materialet e rregullës 102(3). E di që duhet më qartësi në
8 lidhje me këto çështje. Për shembull mocioni -- parashtrimet e
9 palëve edhe në lidhje me mocionet paraprake, kanë qenë mjaft
10 intensive. Palët kanë kërkuar të gjitha zgjatje të afateve. Ka
11 momentalisht 7 mocione që mbulojnë 81 pika, që janë arsye për
12 apel dhe ZPS-ja po ju përgjigjet atyre.

13 Ka edhe mocione në lidhje me çështje të kushtetutës dhe
14 këto pritet të vazhdojnë edhe kësaj jave.

15 Mocionet paraprake dhe intensiteti i tyre do të vazhdojnë
16 edhe për një kohë. Ne sikurse e thashë edhe më herë, nuk kemi
17 një qartësi në lidhje me vëllimin e dokumenteve të nxjerrjes
18 sipas rregullës 102(3). Megjithatë, mbas parashtrimeve që u
19 bënë sot, ka arsye për të pritur që nxjerrja e këtij materiali
20 do të shfrytëzojë të gjitha kapacitetet që kemi, të paktën
21 deri në tetor apo nëntor.

22 Shkurtimisht, puna po vazhdon në mënyrë intensive madje
23 edhe më intensivisht në krahasim me disa muajt e fundit. Ne
24 mund të konfirmojmë që nuk do të jemi në pozitë të nxjerrim
25 materiale të rregullës 95(4) deri në tetor por për fat të keq

1 jo në pozitë që të caktojmë një datë konkrete për këtë.

2 Ne vazhdojmë punën në lidhje me materialet e 95(4), do të
3 vazhdojmë ta informojmë Gjykatën në lidhje me këtë punë dhe
4 është në interesin tonë gjithashtu që këto materiale të
5 mundësohen sa më shpejt që të jetë e mundur.

6 Në lidhje me dorëzimin e një liste paraprake të
7 dëshmitarëve, me 6 gusht ZPS-ja informoi ekipet e Mbrojtjes
8 për tre persona, deklaratat apo dëshmitë e mëparshme të të
9 cilëve janë marrë parasysh në aktakuzë dhe janë përfshirë në
10 materialet mbështetëse të aktakuzës.

11 Vazhdon të jetë qëndrimi jonë se ZPS-ja do të vazhdojë të
12 mbështetet në dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, materiale në
13 lidhje me të cilët tashmë janë nxjerrë dhe në varësi të disa
14 çështjeve që lidhen me miratim apo të ndryshimit të masave
15 mbrojtëse që i përmenda më herët, pritet që kjo të lidhet me
16 320 persona.

17 Sikurse u tha edhe në Konferencën e mëparshme, Mbrojtja
18 tashmë i ka dëshmitarët dhe materialet në lidhje me ta.

19 Megjithatë, në qoftë se Gjykata e çmon të domosdoshme, ne do
20 të jemi në gjendje që të japim një listë të tillë
21 paraprakisht, në bazë të rregullës 95(4)(b). Kjo listë do të
22 jetë provizore dhe mund të ndryshojë dhe besojmë se një listë
23 e tillë, në qoftë se është e domosdoshme, do të mund ta
24 dorëzojmë deri më 22 tetor.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja

1 prokurore.

2 Urdhëroni, zoti Kehoe.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Është mjaft shqetësuese që dëgjojmë
4 nga Prokuroria se po vazhdon hetimet dhe që nuk kanë një datë
5 të afërt që kur do t'i përfundojnë këto hetime dhe ne kemi një
6 vëllim të madh dokumentesh që duhet t'i përpunojmë përpara se
7 të fillojë çështja.

8 Ju e dini se sipas ligjit, hetimet duhet të përfundojnë
9 përpara se të fillojë ngritja e një aktakuze.

10 Të njëjtën përgjigje morëm nga prokuroria edhe me 14
11 shtator dhe të njëjtën po na thonë tani, se nuk kanë një datë
12 se kur do t'i përfundojnë hetimet.

13 Besoj që duhet të na japin një farë date të afërt se kur
14 do të përfundojnë ato hetime, kur do të jetë fundi, në mënyrë
15 që ne të mund të punojmë dhe të zhvillojmë një gjykim që do të
16 jetë i drejtë dhe i shpejtë. Atëherë këto hetime duhet të
17 përfundojnë në mënyrë që prokuroria t'i drejtohet Mbrojtjes me
18 fjalët "ja, këto materiale i kemi dhe me këto materiale duhet
19 të merreni".

20 Ne mirëpresim një listë. Çfarëdo liste dëshmitarësh, apo
21 si do ta quajë Prokuroria. Në këtë moment Prokuroria ka marrë
22 vendim se një numër dëshmitarësh do të ftohen për të dhënë
23 dëshmi të drejtpërdrejtë këtu dhe në fakt ata na kanë
24 informuar për katër persona të cilët nuk ka ndërmend t'i
25 thërrasë për të dhënë dëshmi.

1 Ne e çmojmë këtë, por lidhur me segmentin e parë të kësaj
2 liste paraprake, shpresojmë që këta të jenë dëshmitarë që
3 Prokuroria në fakt ka marrë vendim t'i thërrasë. Ne nuk kemi
4 pra, datë konkrete se kur do të përfundojë hetimi i
5 Prokurorisë. Ne i kemi kërkuar Gjykatës që këtë t'ja
6 parashtrojë Prokurorisë, ta pyesë prokurorinë se kur do t'i
7 përfundojë hetimet e veta. Faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.
9 Urdhëroni, zoti Emerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë mbështes qëndrimin e zotit
11 Kehoe, por dua konkretisht të përqendrohem në pikën b të
12 listës suaj.

13 Ndoshta është çështje përkthimi, por parashtrohet pyetja
14 në qoftë se Prokuroria është e gatshme të paraqesë një datë
15 për dorëzimin e dosjes paraprake. Nuk është detyrë e
16 Gjykatësit që t'i kërkojë Prokurorisë se kur është e gatshme
17 ta bëjë një gjë të tillë. Është detyrë e Gjykatësit që ta
18 urdhërojë Prokurorinë të bëjë një gjë.

19 Ne e ftojmë Prokurorinë të caktojë një datë të tillë. Ne
20 e dimë se asgjë që thotë Prokuroria në lidhje me afatet është
21 e besueshme dhe kjo është qasje e gabuar.

22 Ju si Gjykatës duhet t'i urdhëroni afatet. Në konferencën
23 e pestë të gjendjes me datë 19 maj, Prokuroria ju tha se
24 dosjen paragjyqësore do ta kenë të gatshme nga mesi i tetorit.
25 Dhe pothuaj ka një vit që Prokuroria ju thotë se gjykimi është

1 i gatshëm për të filluar në qershor të këtij viti. Edhe
2 njëherë po e përsëris se në konferencën pestë ata thanë që
3 janë të gatshëm të dorëzojnë dosjen paraprahe nga mesi i
4 tetorit dhe ju duhet ta bëni këtë. Duhet t'i urdhëroni që kjo
5 datë të jetë data e dorëzimit të dosjes paraprahe sepse
6 ndryshe kjo do të interpretohet si thjesht ftesë e Gjykatësit
7 drejtuar Prokurorisë që të caktojë datën vetë se kur është e
8 gatshme që të dorëzojë dosjen paraprahe. Dhe kjo është
9 plotësisht e papranueshme në një situatë, rrethana kur është
10 Gjykatësi ai që cakton oraret dhe që administron çështjen.

11 Prokuroria na ka dalë jashtë kontrollit. Ata kanë pasur
12 të gjitha mundësitë e mundshme. Ata e kanë ditur çështjen e
13 diskutueshme të juridiksionit. Ata edhe në konferencën e
14 fundit na thanë që do të jenë të gatshëm nga mesi i tetorit.
15 Ju duhet ta dini se ne duhet ta kemi parasysh, të kemi një
16 pasqyrë të çështjes që na pret. Duke marrë parasysh këtë kaos
17 dhe këtë keqinterpretim dhe keqpërfaqësim konstant nga ana e
18 Prokurorisë, është thjeshtë një mungesë e parashikueshmërisë.
19 Po ju japim një arsye që për ne ishte e parashikueshme dhe
20 pastaj ju ja lini përsëri Prokurorisë që të zgjedhës se ku
21 janë të gatshëm të dorëzojnë dosjen paraprahe.

22 Ky nuk është administrim i mirë i çështjes, me gjithë
23 respektin që kam për ju. Duhet të urdhërohet Prokuroria që ta
24 dorëzojë këtë dosje më së voni deri me 31 tetor dhe pastaj
25 mund t'i diskutojmë këto çështje të tjera që lidhen me dosjen

1 paraprake si lista e dëshmitarëve që përmendet.

2 Deri më datën 31 tetor do të bëhet një vit - ose një
3 moment t'i kem datat e sakta. Pothuaj se një vit që të
4 akuzuarit ndodhen në paraburgim dhe ju me siguri që ndani
5 mendimin tim se mbas një viti të kaluar në para burgim të
6 akuzuarit kanë çdo të drejtë të dinë se cila është çështja e
7 Prokurorisë kundër tyre.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
9 Emmerson.

10 Zoti Young, urdhëroni.

11 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Ne e kemi
12 ngritur këtë çështje edhe në konferencën e parë, a të dytë për
13 ecurinë e çështjes. Kam përdorur një pyetje, është përdorur
14 një fjalë në frëngjisht, fjala gijotinë. Nuk e dimë, patëm
15 edhe një diskutim atëherë lidhur me këtë fjalë, domethënë që
16 bëhej fjalë për datën prerëse kur të mbylleshin përfundimisht
17 hetimet e Prokurorisë, për t'i dhënë mundësi Mbrojtjes për të
18 parë se çfarë i është nxjerrë, për të pasur një hapësirë për
19 të marrë frymë dhe për të vazhduar çështjen prej atëherë.

20 Ajo që ka thënë zoti Emmerson, ka ardhur momenti dhe për
21 të dhënë edhe një shprehje tjetër në frëngjisht, nëse mundem,
22 realiteti është që kësaj Prokurorie nuk duhet që t'i lejohet
23 një kartë *blanche* për të vijuar me mënyrën e tyre se si ta
24 procedojnë këtë çështje. Prandaj unë ju kërkoj juve, i nderuar
25 Gjykatës, që të merrni një vendim gjyqësor lidhur me afatet.

1 Nuk mund t'i lihet dorë e lirë Prokurorisë që të përdorë një
2 kartë *blanche* prandaj edhe unë do t'i drejtohesha çështjes së
3 menaxhimit të çështjes në këtë rast, drejtpërdrejtë për këtë
4 procedurë gjyqësore.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Zoti Young.

6 Zonja Alagendra apo zoti Ellis?

7 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
8 Gjykatës, ne jemi dakord me bashkëfolësit.

9 Në aspektin praktik, ne po kështu themi se dhënia e
10 listës paraprake të dëshmitarëve, duke e ditur se është listë
11 paraprake, do të ishte jo vetëm e dobishme por edhe thelbësore
12 për përgatitjen e Mbrojtjes mbi një numër tashmë të madh
13 dokumentesh, duke pasur parasysh që kemi edhe në mungesë të
14 mjeteve ndihmëse për t'i naviguar këto dokumente. Prandaj edhe
15 kjo listë paraprake duhet të na jepet sa më shpejtë, e
16 shoqëruar edhe me paketat përkatëse, duke i lidhur dokumentet
17 me dëshmitarët.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Ellis.

19 Zoti, Kehoe, shumë shkurt ju lutem.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Desha ta ngre këtë se pse lidhet kjo
21 temë me tjetrën që vjen pastaj. Data për aktakuzën e pa
22 redaktuar, i nderuar Gjykatës, na ka kërkuar që të japim
23 njoftim [e pa kuptueshme] mirëpo kjo lidhet me aktakuzën pa
24 redaktuar. Jo vetëm për ne por -- a ka ndonjë datë në të
25 ardhmen e afërt kur Mbrojtja do të marrë një aktakuzë komplet

1 të pa redaktuar. Mund të jetë nën vulë gjyqësorë apo masa të
2 tjera mbrojtëse por të paktën në mënyrë paraprake neve na
3 duhet që të dimë se çfarë janë këto redakte në aktakuzë.
4 Sepse bëhet fjalë për data, për vende e kështu me radhë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Zonja prokurore, e mirëpres propozimin tuaj për të
7 përgatitur listat paraprake të dëshmitarëve brenda afatit që
8 keni propozuar ju. Mbajta shënim se kjo është diçka të cilën
9 do ta diskutoni *inter partes* dhe do të përgatite në javët në
10 vijim. Për aspektet e tjera të ngritura nga ekipet e Mbrojtjes
11 jo vetëm problemi i mbylljes së hetimeve, ngritur nga disa
12 ekipe të mbrojtjes dhe i datës "gijotinë", por edhe për dosjen
13 paraprake gjyqësore tuajën dhe me kërkesën e parashtruar këtu
14 që unë të jap një urdhër për një afat në përputhje me
15 vlerësimet tuaja kohore.

16 Keni fjalën.

17 Znj. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës,
18 mbajtëm edhe ne shënim dhe ne do ta japim këtë listë brenda
19 kohës që unë e përmenda.

20 Sa i takon hetimeve në vazhdim e sipër, i kam trajtuar
21 këto në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes dhe kam
22 parashtruar gjatë aty kështu që nuk dua t'ju përsëris ato, por
23 hetimet e mëtejshme përfshijnë edhe çështje të tjera gjyqësorë
24 që bën Zyra e Prokurorit, të lidhura edhe me këtë çështje dhe
25 është përgjegjësi e Zyrës së Prokurorit për ta bërë këtë gjë.

1 Sa i takon dosjes paraprahe, Mbrojtja e ka keq paraqitur
2 atë që ne thamë më konferencën e fundit për ecurinë e
3 çështjes. Ne asokohe nuk premtuam asnjë datë.

4 Siç e përmenda në parashtrimet sot, ka një sërë faktorësh
5 që kam përmendur unë, të cilët do të ndikonin në këtë afat dhe
6 me gjasë, në mënyrë të konsiderueshme, në varësi edhe të
7 burimeve që do të kërkojë kjo gjë. Dhe unë e kam shpjeguar
8 edhe më tej sot dhe të gjitha palët janë në dijeni se sa shumë
9 burime kërkojnë këto dy aspekte të cilat unë i përmenda dhe
10 kërkojnë burime nga të gjitha palët, jo vetëm nga ana e
11 Prokurorisë.

12 Vlerësimet kohore që jepen në çdo moment mbështeten në
13 informacionet që ka pala përkatëse në atë moment. Prokuroria
14 nuk është ajo që dikton afatet në këtë çështje gjyqësore.

15 Gjykatësi i procedurës paraprahe ka vendosur një kalendar
16 të procedurës paraprahe, përfshirë këtu edhe nxjerrjet e
17 materialeve. Prokuroria po bën atë që është duke u përpjekur
18 që të qëndrojë brenda afateve realiste në bazë të rrethanave
19 në të cilat ndodhet.

20 Unë nuk mendoj se përfiton ndonjë palë që të vendoset një
21 afat jo realist. Siç e thashë, ne vijojmë që të punojmë edhe
22 në këtë aspekt me shpejtësinë e mundshme dhe sigurisht është
23 në interesin tonë që t'i japim këto materiale sa më shpejt.

24 Mendoj se kam qenë e qartë që tetori nuk është një datë
25 realiste për ne duke pasur parasysh rrethanat e tanishme.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja prokurore, më duhet
2 të rikujtoj këtu se ju folët për afate jo realiste por afati
3 në fjalë propozuar nga ju, nga zyra juaj, domethënë, u
4 propozua nga zyra juaj në nëntor të vitit që shkoi por edhe në
5 disa konferenca mbi ecurinë e çështjes. Unë ju kuptoj,
6 sigurisht, prandaj edhe unë i dëgjoj palët përpara se të
7 vendos afate, sepse mendoj se është e rëndësishme që çdo palë
8 që ndodhet këtu, të jetë në gjendje të bëjë punën e vet.
9 Prandaj të kemi edhe një procedurë ballafaquese të plotë.
10 Prandaj dhe unë jam përpjekur të vendo afate realiste gjatë
11 gjithë kësaj procedure prandaj edhe unë mbështetem në
12 propozimet që ZPS-ja ka dhënë në muajt e mëparshëm.

13 Unë e kuptoj atë që thoni, unë nuk dua të vendos afate
14 jorealiste, por këtu edhe unë duhet që të jem konsekuent me
15 kalendarin që kanë vendosur dhe me vlerësimet kohore të
16 secilës palë.

17 Unë e kuptoj se sot ndodheni në një situatë të vështirë
18 për të propozuar një afat. Atëherë këtë afat do ta vendos unë
19 dhe do ta vendos në javët në vijim. Nuk mund të presim më për
20 dorëzimin e dosjeve paraprake nga ZPS-ja. Unë mendoj se zoti
21 Ellis ka shumë të drejtë që duhet të jenë edhe ata të qartë.
22 Po i afrohem një vjetorit të fillimit të kësaj procedure
23 ballafaquese në procedurë paraprake. Prandaj na duhet që të
24 ecim dhe më duhet që ta vendos afatin e dorëzimit të dosjes
25 paraprake të paktën në konferencën e ardhshme për ecurinë e

1 çështjes.

2 Zonja prokurore?

3 Znj. LAWSON: [Përkthim] Ju kuptuam shumë mirë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Zoti Emmerson, shumë shkurt.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nëse do të mundem, do t'i bie
7 shkurt por për të qenë tërësisht i qartë, në konferencën e
8 fundit për ecurinë e çështjes na u tha se dosja paraprake do
9 të ishte gati deri në mes të tetorit por nuk ka ndodhur asgjë
10 e re prej atëherë për ta justifikuar një shtyrje të afatit.
11 Asokohe Prokuroria e dinte materialin që kishte prapësime
12 kushtetuese, i dinte edhe rrethanat e tjera që ajo përmend
13 këtu.

14 Nuk mjafton që të themi që do ta vendosim datën në
15 konferencën e ardhshme të ecurisë së çështjes sepse konferenca
16 e ardhshme për ecurinë e çështjes do të jetë përtej datës së
17 duhur dhe data e duhur duhej të ishte 1 tetori.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Emmerson, ju dëgjova.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju dëgjova dhe thatë se do ta
20 vendosni afatin.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë thash që do ta vendos
22 datën maksimumi brenda konferencës së ardhshme për ecurinë e
23 çështjes.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ajo që po përpiqem të them është
25 kjo --

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju kuptoj, por nuk duhet të
2 ridiskutojmë edhe një herë vendimet e mëparshme. Nuk duhet të
3 ridiskutojmë edhe një herë argumente për të cilat ju keni
4 dhënë parashtrime.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do them diçka tjetër. Më datë 21
6 korrik, në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes --
7 sepse deri tani po flas vetëm për dosjen paraprahe. Duhet të
8 ketë të paktën një projekt dosjeje paraprahe. Sepse ato nuk ka
9 mundësi t'ju kenë bërë këtë premtim.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po mua nuk më intereson
11 projekti i dosjes paraprahe. Mua më intereson versioni
12 përfundimtari, i finalizuar i dosjes paraprahe në mënyrë që
13 ekipet e Mbrojtjes të bëjnë punë të duhur.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pikërisht, pra, ata kanë pasur
15 kohë të mjaftueshme për të finalizuar atë version paraprahe.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju kuptova saktë.

17 Ndonjë ekip tjetër i mbrojtjes që kërkon fjalën? Nuk shoh
18 ndonjë?

19 Zoti Kehoe, shumë shkurt ju lutem.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Përfaqësuesja e Prokurorisë nuk ju
21 drejtua çështjes së aktakuzës së paredaktuar. A mund të bëhet
22 kjo në ditët në vijim?

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja prokurore? Për këtë
24 çështje?

25 Znj. LAWSON: [Përkthim] Nuk është e mundshme që të bëhet

1 kjo në ditët e ardhshme. Ka disa redakte në të që kanë të
2 bëjnë me masa mbrojtëse të cilat janë urdhëruar. E shqyrtojmë
3 vazhdimisht në fakt dhe i heqim redaktimet në momentin kur
4 mund të hiqen. Në fakt në versionin e aktakuzës që është
5 dorëzuar më datë 3 shtator janë hequr disa redakte, në fakt.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
7 prokurore.

8 Kalojmë tani në temën tjetër të rendit të ditës që ka të
9 bëjë me paraburgimin. I lutem Zyrës Administrative që të na
10 japi një përditësim për regjimin e paraburgimit, përfshirë
11 këtu ndër të tjera edhe politikat e ndjekura, pra vizitat e
12 avokatëve dhe të familjarëve. Ftoj edhe palët që të bëjnë të
13 ditur nëse masat e fundit të zbatuara nga Zyra Administrative,
14 u japin zgjidhje shqetësimeve të tyre.

15 Zoti Roche, fjala është për ju.

16 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit. Siç jeni në dijeni nga
17 parashtrimet e mëparshme, në bazë të vlerësimit të rrezikut të
18 pandemisë, janë marrë masat e duhura për t'u dhënë zgjidhje
19 këtyre rreziqeve. Duke filluar nga data 1 korrik, janë
20 mundësuar vizitat personale të avokatëve. Nga data 15 korrik
21 në të njëjtën dhomë madje. Këto kanë vijuar. Secili prej të
22 bashkakuzuarve në këtë çështje kanë pasur vizita nga avokatët
23 e tyre, me përjashtim të një në fakt, prej tyre. Duke filluar
24 nga data 6 shtator, kufizimet e mbetura mbi vizitat personale
25 janë hequr. Pra nga data 15 korrik, familjarë të afërm mund të

1 vizitonin dhe nga data 6 shtator, edhe vizitat e tjera
2 personale janë të mundshme, që ka çuar në një rritje të
3 konsiderueshme të numrit të vizitorëve në objektin e
4 paraburgimit.

5 Më në përgjithësi ne vijojmë të punojmë me zyrtarin
6 mjekësor për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur
7 për të paraburgosurit, por edhe për personat e tjerë. Nëse do
8 të ketë gjëra të tjera që do të ngrihen këtu do të përpiqem
9 t'u përgjigjem.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Roche.

11 Ndonjë prej ekipeve të mbrojtjes dëshiron që të thotë
12 ndonjë gjë?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Young?

15 Z. YOUNG: [Përkthim, përmes video lidhjes] Jo.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Alagendra?

17 Znj. ALAGENDRA: [Përkthim, përmes video lidhjes] Jo.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

19 Kalojmë tani në pikën tjetër të rendit të ditës që janë
20 hetimet e Mbrojtjes.

21 Mbrojtja e zotit Krasniqi ka bërë të ditur në
22 parashtrimet me shkrim se mbrojtja ka filluar hetimet por
23 mbetet e kufizuar nga disa faktorë. Do të doja që të dëgjoja
24 nga mbrojtja lidhur me ecurinë e hetimeve të tyre, në veçanti,
25 në bazë të vlerësimeve të ZPS-së dhe të procesit të nxjerrjes

1 së materialeve tani, Mbrojtja a mund të na japë ndonjë
2 informacion në lidhje me ecurinë e hetimeve?

3 Nëse Mbrojtja mund të na japë informacione me synimin e
4 tyre për të bërë kërkesa lidhur me mundësinë hetimor unike dhe
5 në përputhje me rregullën 99(1) dhe nëse Mbrojtja mund të na
6 bëjë të ditur nëse ka synim të bëjë njoftim alibie apo arsye
7 për të përjashtuar përgjegjësinë.

8 Zoti Kehoe, fjala është për ju.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, duke pasur
10 parasysh ecurinë e nxjerrjeve, nuk mund t'ju jap një vlerësim
11 se kur do të zhvillohet apo do të plotësohet një hetim. Po
12 shqyrtojmë informacionet që po na jep Prokuroria. Po flasim
13 edhe me përfaqësuesit e Prokurorisë, sigurisht. Por janë të
14 vështira edhe vajtjet e ardhjet në Kosovë, siç mund ta
15 kuptoni, për shkak të situatës. Por ka shumë vështirësi,
16 redakte, pengesa, të cilat na vijnë nga prokuroria, çka i ka
17 bërë krejt të vështira hetimet tona. Unë e ngrita çështjen e
18 aktakuzës. I nderuar Gjykatës na përmendi alibinë, njoftimin
19 për alibi, pra po kap paragraf pas paragrafi në aktakuzë ku
20 thuhet që "kjo ngjarje ndodhi në një vend të redaktuar, midis
21 një date të redaktuar, deri në një datë të redaktuar".

22 Tani kjo aktakuzë është e mbushur plot me redakte të
23 tilla. Kjo e bën krejt të pamundur që ne të fillojmë të
24 mendojmë nëse klienti im, mund t'ju them pra ka punuar në
25 nivel ndërkombëtar, ka qenë në lloj-lloj vendesh të Evropës

1 dhe nuk ka qenë në fushë betejat aty ku është zhvilluar
2 konflikti. Por, duke mos ditur datat dhe vendet, është e
3 vështirë.

4 Kur ngrihet një larmi aspektesh, ndërkohë që klienti im
5 ka qenë në Bruksel, në Romë, në Vjenë, por unë nuk mund t'ju
6 them që tani që ai ka qenë në filan qytet apo tjetër. Por unë
7 kur e shikoj aktakuzën nuk e kuptoj se për çfarë bëhet fjalë,
8 kështu që të paktën që në fillim unë e thashë që shpresoj në
9 ditët në vijim që Prokuroria të na japë një aktakuzë të pa
10 redaktuar e cila do të na e fokusojë edhe hetimin se tani për
11 tani, këtë informacion mund ta marrim dhe nuk e dimë se si
12 lidhet drejtpërdrejtë me akuzat e ngritura në atë aktakuzë.

13 Në disa raste është e pa mundur që të bëhet kjo lidhje.
14 Unë ju përgjigja shumë gjatë për të thënë se nuk jemi gati për
15 t'ju thënës e ku jemi me hetimet tona tani për tani.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

17 Zoti Emmerson, fjala për ju.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në emër të zotit Veseli, kemi
19 filluar në mënyrë të konsiderueshme hetimet me aq sa kemi
20 pasur mundësi. Kemi një ekip të ngritur në Kosovë. Kemi bërë
21 vizita për të filluar procesin e identifikimit të dëshmitarëve
22 të mundshëm nga sa ç'mund të kuptojmë ne tani nga çështja.

23 Nëse i nderuar Gjykatës mund të japë urdhër Prokurorisë
24 që Prokuroria të dorëzojë dosjen paraprake brenda datës 31
25 tetor, kjo do të na ndihmonte shumë hetimet tona paraprake.

1 Ajo që dua të them dhe e them publikisht për hir të
2 procesverbalit, është që juridiksione të ndryshme përdorin
3 terma të ndryshëm, por në juridiksionin tonë është që ajo që
4 themi është që barra nuk i takon personit. Pra ne punojmë në
5 të verbër. Prandaj edhe ne nuk kemi asnjë detyrim që të
6 njoftojmë Prokurorinë se për kë duam të flasim ne se
7 Prokuroria nuk ka dalë hapur me argumentet e veta.

8 Kështu siç jemi hë për hë, Mbrojtja e konsideron veten të
9 lirë që të bëjë të gjitha hetimet që konsiderohen të
10 përshtatshme, pa informuar Prokurorinë apo gjykatën dhe nëse
11 është dikush këtu që nuk është dakord, le të çohet tani e të
12 na thotë pse dhe për ç'arsye.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
14 Emmerson.

15 Zoti Young?

16 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Shumë shkurt
17 për arsyet që u shprehën nga zoti Kehoe, por edhe duke
18 parasysh që është e paqartë se cilat janë provat kundër zotit
19 Rexhep Selimi, unë nuk mund t'ju informoj sot lidhur me këto
20 gjëra.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young.

22 Zonja Alagendra?

23 Znj. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I
24 nderuar Gjykatës, unë ju dëgjova që ju thatë që do të caktoni
25 afatin në javën në vijim për dorëzimin e dosjes paraprake.

1 Dorëzimi i dosjes paraprake nuk do të thotë me doemos që
2 mbrojtja është gati për mbrojtjen. Vështirësitë me të cilat ne
3 jemi hasur vijnë. Ne i kemi përshkruar këto në parashtrimet
4 tona me shkrim, i mbështes ato dhe unë mbështes edhe kolegët e
5 mi të Mbrojtjes në argumentet që ata kanë parashtruar këtu.
6 Prandaj edhe unë nuk mund t'ju jap dot një informacion mbi
7 ecurinë e hetimeve tona. Faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja
9 Alagendra.

10 Prokuroria dëshiron të thotë diçka lidhur me këtë pikë të
11 rendit të ditës?

12 Znj. LAWSON: [Përkthim] Sa i takon asaj që thamë,
13 mbrojtja e zotit Veseli, sa i takon kontaktimit të
14 dëshmitarëve, kjo rregullohet nga shumë institucione dhe ne e
15 rezervojmë të drejtën që të bëjmë parashtrime të tjera me
16 shkrim lidhur me këtë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E mbajta shënim.

18 Kalojmë tani në pikën e fundit të rendit të ditës, që
19 është data për konferencën tjetër për ecurinë e çështjes. I
20 informoj palët se duke pasur parasysh se Trupi Gjykses numër
21 një do të fillojë çështjen gjyqësore numër pesë nesër dhe
22 Trupi Gjykses numër dy, do të fillojë gjykimin e çështje
23 shtatë, në fillim të tetorit, salla e gjyqit do jetë më pak e
24 disponueshme në javët në vijim. Pasi jam konsultuar me trupat
25 e tjerë gjykses, informoj palët se kam ndërmend që ta caktoj

1 datën e konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes ditën
2 e premte 29 tetor, në orën 2 e gjysëm pas dreke, pra 14.30
3 sipas orës së Hagës. I informoj palët se kam rezervuar edhe
4 një datë dhe një orë për konferencën tjetër të ecurisë së
5 çështjes për datën 15 dhjetor, ditë e mërkurë, ora 14.30.

6 Ju jap fjalën tani të gjitha palëve dhe pjesëmarrësve.

7 Zonja prokurore?

8 Znj. LAWSON: [Përkthim] Ne jemi të disponueshëm në atë
9 datë që vutë ju në dukje.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Kehoe?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe ne do të jemi të disponueshëm.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Kehoe.

13 Zoti Emmerson?

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe ne gjithashtu.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti

16 Emmerson.

17 Zoti Young?

18 Z. YOUNG: [Përkthim, përmes video lidhjes] Po, shkurt.

19 Për fat të keq, 29 tetori është e vështirë për mua. Nuk e di
20 nëse do të kishit mirësinë të vendosni një datë në javën e
21 parë të nëntorit. Nëse dëshironi që të bëj parashtimin me
22 shkrim këtë mund ta bëjmë por atë datë e kam vështirë si në
23 profesionin tim kam një punë tjetër. Nëse mund ta shtyni pak
24 ditë, nëse është mundur javën e parë të nëntorit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të konsultohem me

1 kolegët, por nuk ju premtoj dot asgjë sepse është shumë e
2 vështirë nga pikëpamja organizative.

3 Bashkë-avokatët e tjerë a do të ishit të disponueshëm
4 nëse e lëvizim datën? Zoti Roberts është këtu? Zoti Roberts
5 mund të flasë.

6 Z. ROBERT: [Përkthim] [Përmes video lidhjes] Po, i
7 nderuar Gjykatës.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të shoh ç'mund të bëj,
9 por nuk ju premtoj dot.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë do të kundërshtoj sepse
11 konferenca tjetër do të ishte përpara datës 31, kështu që e
12 kundërshtoj. Në qoftë se zoti Roberts është i disponueshëm në
13 atë datë, në rregull. Thjesht për ta siguruar zotin Emmerson.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti Young, e
15 vlerësojmë shumë. Në fakt unë do të parapëlqejë që konferencën
16 ta kishim përpara 31 tetorit.

17 Zonja Alagendra?

18 Znj. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe ne
19 jemi të disponueshëm.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Laws?

21 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Gjithashtu edhe
22 ne.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë. Do të
24 merrni urdhrin ku do të përfshihet edhe agjenda në kohën e
25 duhur. I ftoj palët si zakonisht të bëjnë parashtime me

1 shkrim, si zakonisht, nëse duan të ngrenë ndonjë çështje
2 konkrete gjatë konferencës tjetër.

3 Në këtë moment dua t'i pyes palët nëse keni ndonjë
4 çështje tjetër që doni të ngrini.

5 Zona prokurore, ju u përgjigjët, por e keni përsëri
6 fjalën.

7 Znj. LAWSON: [Përkthim] Nuk kam gjë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Kehoe?

9 Z. KEOHE: [Përkthim] Jo, i nderuar, thjesht t'ju nxis që
10 të vendosni një afat për hetimet e mëtejshme të prokurorisë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Emmerson?

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, asgjë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti Young?

14 Z. YOUNG: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, nuk kemi.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Alagendra?

16 Znj. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Asgjë
17 tjetër, për veçse nëse kërkojmë të paraqesim parashtrimin me
18 shkrim për afatin -- zgjatjen e kohës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk e kuptova.

20 Znj. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nëse
21 duhet që të paraqesim parashtrime me shkrim sipas rregullit
22 102(3).

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, sepse do të jap një
24 urdhër me gojë sot.

25 Znj. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jemi

1 mirënjohës.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Do të lëshoj disa urdhra me
3 gojë.

4 Urdhrin e parë me gojë. Lidhur me nën kategorizimin për
5 materialet e rregullës 102(1)(a). Kujtoj vendimin tim për
6 kategorizimin e vendimeve të nxjerrë në 12 mars të vitit 2021,
7 ku vendosa që nuk nevojitej kategorizim i mëtejshëm lidhur me
8 materiale të rregullës 102(1)(a) sepse Mbrojtja kishte
9 përfituar nga udhëzimet e dhëna në paraqitjen e hollësishme të
10 përgatitur nga ZPS-ja në bazë të rregullave 86(4) të
11 rregullores.

12 Vërej gjithashtu se materialet e rregullës 102(1)(a) për
13 fitojnë nga zbatimi i rregullës standarde 102(c) në Legal
14 Workflow. Në këtë kuadër gjej se koha dhe burimet që do të
15 kërkoheshin për të zbatuar nënkategorizimin për materialet e
16 rregullës 102(1)(a) do ta ngadalësonin procesin e nxjerrjes së
17 materialeve dhe nuk do të shtonte ndonjë material duke pasur
18 parasysh instrumentet që ekzistojnë për kategorizimin e një
19 materiali të tillë.

20 Rrjedhimisht, nuk e pranoj kërkesën e Mbrojtjes për
21 nënkategorizimin e materialeve të rregullës 102(1)(a). Këtu
22 përfundon urdhri imi parë me gojë.

23 Urdhri dytë ka bërë me afatin e ZPS-së lidhur me
24 materialeve të rregullës 102(b). Nën dritën e parashtimeve të
25 Prokurorisë dhe disa faktorë të jashtëm kanë vonuar nxjerrjen

1 e deklaratave të tre dëshmitarëve ndërkombëtarë që presin
2 miratimet sipas rregullës 107. Raporte të tre eksperte për
3 çështje mjeko-ligjore dhe së treti për disa materiale që janë
4 objekt i kërkesave për ndryshimin e masave mbrojtëse.

5 Rregulli aktual 102(1)(b), afati në bazë të këtij
6 rregulli, është ndryshuar dhe ZPS-ja urdhërohet që këtë
7 materiale t'ia bëjë të njohura Mbrojtjes deri në 1 nëntor
8 2021.

9 Lidhur me përkthimin e materialeve të rregullës
10 102(1)(b), urdhëroj ZPS-në të japë përkthimet e mbetura sa më
11 shpejt që të jetë e mundur dhe në mënyrë të vazhdueshme por jo
12 më vonë se 1 nëntori i vitit 2021.

13 Çdo kërkesë për zgjatjen e afatit në lidhje me përkthimin
14 dhe/ose nxjerrjen e materialeve të mbetura në bazë të
15 rregullës 102(1)(b) duhet bërë me shkrim dhe të jetë i
16 hollësishëm, të përcaktojë materialin me të cilin lidhet deri
17 në 27 tetor të vitit 2021, të mërkurën.

18 Këtu përfundon dhe urdhri imi dytë me gojë.

19 Do të lëshoj urdhrin e tretë lidhur me afatet e Mbrojtjes
20 në lidhje me materialet e rregullës 102(3).

21 Për sa i takon kërkesës së Mbrojtjes për të zgjatur
22 afatin për kërkimin e qasjes së materialeve të rregullës
23 102(3) janë treguar prova, arsye të mjaftueshme për zgjatjen e
24 një afati të ri.

25 Nën dritën e numrit të madh të dokumenteve për njoftimin

1 e ZPS-së në bazë të rregullit 102(3) dhe faktin që vlerësimi i
2 rëndësisë do të ndihmojë nga shikimi i materialeve, nga
3 analiza e materialeve të nxjerra nga ZPS-ja, në bazë të
4 rregullës 102(1) (b) .

5 Afati për të gjitha ekipet e Mbrojtjes për të kërkuar
6 materialet e rregullës 102(3), siç parashikohet në vendimin
7 tim të 24 qershorit zgjatet deri në 5 nëntor të vitit 2021.

8 E urdhëroj gjithashtu ZPS-në që jo më vonë se të premtën
9 26 nëntor të vitit 2021, apo brenda tre javësh që nga
10 indikacioni i Mbrojtjes, cila datë do të jetë më e hershme, së
11 pari të nxjerra apo të ofrojë qasje në materialet e zgjedhura
12 që nuk kërkojnë redaktime dhe së dyti të paraqesë një kërkesë
13 për masa mbrojtëse, në qoftë se ka, lidhur me materialet e
14 kërkuara nga Mbrojta dhe të nxjerrë sa më shpejtë që të jetë e
15 mundur një material të tillë me redaktime, nëse miratohen dhe
16 e urdhëroj ZPS-në që të më kontaktojë brenda 10 ditësh nëse ka
17 një kundërshtim lidhur me rëndësinë e provave.

18 Së fundi, afati për të kërkuar hollësi të mëtejshme
19 mbetet.

20 Këtu përfundon edhe urdhri im i tretë me gojë.

21 Së fundi, do të lëshoj edhe një urdhër të katërt me gojë
22 lidhur me parashtrimin e listës paraprake të dëshmitarëve. Nën
23 dritën e parashtrimeve të palëve, e urdhëroj ZPS-në t'i ofroj
24 Mbrojtjes listën paraprake të dëshmitarëve deri në 22 tetor të
25 vitit 2021.

1 Këtu përfundon edhe urdhri i im i fundit me gojë dhe këtu
2 përfundon edhe seanca jonë sot. Falënderoj palët dhe si
3 gjithmonë falënderoj përkthyesit për fleksibilitetin,
4 stenografët, teknikët audio-vizualë, personelin e sigurisë për
5 ndihmën e tyre.

6 Kjo seancë përfundon këtu. Të gjithë në këmbë.

7 --- Konferenca mbi Ecurinë e Çështjes mbyllet
8 në orën 17.28

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25